



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 3 (827754)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 21 Janar 2022

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, vizitë zyrtare në Romë



Peleshi: Shqipëria, mision kyç për ruajtjen e orientimit strategjik euroatlantik në rajon

Shqipëria ka mision kyç jo vetëm për ruajtjen e paqes dhe sigurisë, por edhe orientimin strategjik euroatlantik në rajon. Kjo u konfirmua nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi gjatë vizitës së tij zyrtare në Romë, ku u takua me homologun e tij, z. Lorenzo Guerini. Në qendër të diskutimit të të dy ministrave të Mbrojtjes

ishite bashkëpunimi mes dy vendeve në këtë fushë, i cili ndër vite rezultoi shumë intensiv. Nga ana e tij, ministri Peleshi e falënderoi përزمërsisht homologun Guerini për mbështetjen e pakushtëzuar të Italisë për Shqipërinë, në rrugën drejt Bashkimit Europian. Duke folur për... >>> faqe 2

INTERVISTA

Në panteonin e yjeve të Partizanit, legjenda e basketbollit Gazmend Çaçi



>>> faqe 6-7

Nis puna për Bazën Ajrore të NATO-s në Kuçovë

Rama e Peleshi: Shqipëria, vlerë e shtuar e Aleancës

Shndërrimi i Bazës Ajrore të Kuçovës në bazë ajrore të NATO-s, një mundësi e shkëlqyer për FA në ngritjen e kapaciteteve kombëtare dhe modernizimin e Forcës Ajrore >>> faqe 3



Takimi i Komitetit Ushtarak të NATO-s

Gjeneralmajor Begaj: FA, angazhim maksimal për ndjekjen me interes të situatës në kufirin me Ukrainën

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneralmajor Begaj, mori pjesë në takim virtual të Komitetit Ushtarak të NATO-s, në nivel shefash shtabi, i cili ishte i pari për vitin 2022. Në hapjen e ditës së parë të takimeve, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Bauer vlerësoi rëndësinë e këtij takimi sidomos për ambientin e sigurisë që NATO është duke u përballur...



>>> faqe 4

Ceremonia

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Respektoj kontributin jetësor të gjeneral Bitrit në FA

Në praninë e ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor, Prof. Asoc. Bajram Begaj, komandantëve të forcave dhe atyre mbështetëse, kolegëve dhe familjes së gjeneral brigade Bitrit, u zhvillua në Ministrinë e Mbrojtjes ceremonia e vendosjes së gradës... >>> faqe 8

Aleanca e gatshme të vazhdojë dialogun me Rusinë

Stoltenberg: NATO nuk do të bëjë kompromis mbi parimet thelbësore për sigurinë europiane

>>> faqe 8

KOMANDANTI I RI I BATALIONIT TË II TË KËMBËSORISË, I FT

Nënkolonel Kuçana: Besoj tek mrekullia që mund të sjellë puna dhe përkushtimi i secilit

faqe 5

GJERGJ KASTRIOT SKËNDERBEU

Identiteti ynë kombëtar, e shkuara e lavdishme dhe rruga e të nesërme për shqiptarët!

faqe 10



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, vizitë zyrtare në Romë

Peleshi: Shqipëria, mision kyç për ruajtjen e orientimit strategjik euroatlantik në rajon

Ministri i Mbrojtjes Peleshi dhe homologu itij, z. Lorenzo Guerini, bashkëpunimit dypalësh rreth sfidave të mbrojtjes kibernetike

Shqipëria ka mision kyç jo vetëm për ruajtjen e paqes dhe sigurisë, por edhe orientimin strategjik euroatlantik në rajon. Kjo u konfirmua nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi gjatë vizitës së tij zyrtare në Romë, ku u takua me homologun e tij, z. Lorenzo Guerini.

Në qendër të diskutimit të të dy ministrave të Mbrojtjes ishte bashkëpunimi mes dy vendeve në këtë fushë, i cili ndër vite rezultoi shumë intensiv.

Nga ana e tij, ministri Peleshi e falënderoi për zemërsisht homologun Guerini për mbështetjen e pakushtëzuar të Italisë për Shqipërinë, në rrugën drejt Bashkimit Europian. Duke folur për situatën në Ballkanin Perëndimor, ministri Peleshi theksoi se: “Një përshkallëzim negativ i situatës rrezikon efektin domino për të gjithë rajonin. Në këtë drejtim, Shqipëria dhe shqiptarët në rajon kanë një mision kyç, jo vetëm për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe prosperitetit, por edhe për të ruajtur orientimin strategjik euroatlantik të rajonit. Shqipëria është e përkushtuar të promovojë ‘Politikën e Dyrve të Hapura’, për të gjitha vendet e rajonit”.

Zoti Peleshi falënderoi ministrin e Mbrojtjes së Republikës së Italisë, z. Guerini për mbështetjen që Italia i jep Kosovës, si edhe për kontributin e Forcave të Armatosura italiane në KFOR: “Kosova mbetet interes kombëtar për Shqipërinë, e cila tashmë me statusin e vendit anëtar në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për periudhën 2022-2023 do të llojë fuqishëm në rritjen e numrit të vendeve që njohin pavarësinë e saj!”.

Sa i përket bashkëpunimit në kuadër të NATO, të dy ministrat theksuan in-



teresin e përbashkët për një vëmendje të madhe ndaj rreziqeve dhe sfidave që burojnë nga Drejtimi Strategjik Jugor i Aleancës. Me rëndësi u vlerësua rakordimi i qasjes mbi “Konceptin e

Ri Strategjik të NATO-s”, i cili pritet të miratohet në Samitin e Madridit, në qershor. Ministrat e Mbrojtjes të Italisë dhe Shqipërisë ranë dakord për vijimin e bashkëpunimit dypalësh rreth sfidave



të mbrojtjes kibernetike, apo edhe në fushën e arsimit apo trajnimit, për të cilat ministri Peleshi tha se hapin mjaft dritare mundësish për personelin shqiptar. Dy ministrat ranë dakord gjithashtu

të zgjerojnë marrëveshjen aktuale në fushën e mjekësisë ushtarake.

Teksa e falënderoi për mikpritjen, ministri Peleshi e ftoi homologun e tij për një vizitë në Shqipëri.

Ministri Peleshi në Departamentin e Mbrojtjes Civile në Itali

Italia 31 milionë euro për fuqizimin e sistemit të mbrojtjes civile

Fuqizimi i sistemit të Mbrojtjes Civile është një nga prioritetet, për të cilin Ministria e Mbrojtjes po punon prej muajsh. Kjo ishte një nga çështjet që mori vëmendje në takimet që ministri i Mbrojtjes zhvilloi në vijim të vizitës së tij në Itali. Z. Peleshi u prit në takime të veçanta nga shefi i Departamentit të Mbrojtjes Civile Fabrizio Curcio dhe nga komandanti i Komandës së Bashkuar Operacionale, gjenerali Francesco Paolo Figliuolo. Ministri Peleshi, teksa njohu drejtuesit e strukturave të Mbrojtjes Civile italiane me synimet e Ministrisë së Mbrojtjes për të rritur kapacitetet në fushën e emergjencave civile, shprehu vlerësimin e tij për kontributin e Italisë, e cila i ka dhënë Shqipërisë një grant prej 31 milionë eurosh. Projekti parashikon ndërtimin dhe përgatitjen e sallës operacionale të mbrojtjes civile, trajnimin e stafit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, rritjen e kapaciteteve për planifikimin e emergjencave dhe parashikimin e rrezikut, pajisjet për sallat e Operacionale në 4 qendrat e AKMC-së dhe 8 prefektura, si dhe pajisjen me mjete sipas standardeve të kohës.

Gjatë diskutimit mbi forcimin e marrëdhënieve mes dy vendeve në fushën e emergjencave civile si dhe bashkëpunimin e deritanishëm, ministri Peleshi falënderoi Italianë dhe në veçanti Departamentin italian të Emergjencave Civile, për mbështetjen e dhënë në rastin e tërmetit tragjik të vitit 2019 si dhe gjatë pandemisë së COVID-19.



STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shef i Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni “Skënderbej”

Nis puna për realizimin e projektit për modernizimin e Bazës Ajrore të Kuçovës dhe transformimit të saj në Bazë Ajrore Taktike të NATO-s.

Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast morën pjesë kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor Bajram Begaj, ambasadorja e SHBA-së Yuri Kim, ambasadorë të vendeve të tjera të akredituar në Tiranë.

RAMA: “Është shumë e rëndësishme të ruhet paqja dhe stabiliteti, për këtë arsye Shqipëria merr një rëndësi kritike në Ballkan. Këto janë fjalët e Tod Walters, në një vlerësim të bërë prej tij mbi rëndësinë e vendit tonë si pikë ndikuese në Ballkanin Perëndimor dhe në Europë, gjatë një dokumentari të NATO-s për bazën e Kuçovës. Vendimi që mori NATO për ta përzgjedhur këtë mjedis, duke e transformuar në një bazë ajrore taktike të aleancës në rajon, konfirmon faktin se Shqipëria e vogël është një vlerë e shtuar në këtë aleancë, e cila bashkon vende që besojnë në disa vlera dhe parime për të cilat ia vlen të luftohet. Për ne lajmi i kësaj vendimmarrjeje të NATO-s ishte shumë i mirëseardhur, sepse jo vetëm krijonte një vlerë të re në infrastrukturën tonë të mbrojtjes, por përçonte edhe një energji të re në përpjekjen tonë për ta shfrytëzuar me sa më shumë inteligjencë dhe pragmatizëm pozicionin tonë strategjik, në aspektin gjeografik, dhe pozitën tonë në NATO në aspektin politik, por edhe ushtarak.

Jemi dëshmitarë se sa shumë mosbesim ka pasur kur është dhënë lajmi atëherë se NATO do të ngrinte bazën e saj në Kuçovë. Kishte shumë që thoshin që asnjëherë ky moment nuk do të vinte, kur Kuçova do të shndërrohej në vendin ku do të zbatoheshin pesë projekte. Dhe përveç investimeve, do të impaktohet edhe ekonomia, ndërsa në aspektin social zona e Kuçovës do të ketë një përfitim si të ardhur nga qielli. Është bërë zakoni të përmendim ambasadorën e SHBA-së në vendin tonë, por këtë herë më duhet ta përmend se, falë angazhimit të drejtpërdrejtë të ambasadores Kim dhe strukturat e tjera përkatëse, jemi duke folur për një projekt që ka të bëjë me krijimin e një qendre ekselence të mbrojtjes kibernetike, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për gjithë NATO-n.”

Kryeministri theksoi më tej rolin e stërvitjes “Defender 21”, duke shtuar se Shqipëria është në pozicionin më të favorshëm për ta rikthyer atë në vitin 2023. Shndërrimi i Bazës Ajrore të Kuçovës në bazë ajrore të NATO-s, u cilësua nga kryeministri Edi Rama si një mundësi e shkëlqyer për Forcat tona të Armatosura në ngritjen e kapaciteteve kombëtare dhe modernizimin e Forcës Ajrore.

Duke shprehur mirënjohjen, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, deklaroi se kjo nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen pa rezerva të aleatëve tanë dhe lidhshpirt civil-ushtarak të NATO: “Përzgjedhja e Shqipërisë për të zhvilluar këtë projekt, është dëshmi e qartë mbi aftësitë tashmë të konsoliduara të vendit tonë, për të marrë më shumë përgjegjësi dhe për të vazhduar me maturi angazhimin dhe kontributin tonë në arkitekturën e sigurisë së rajonit



Nis puna për Bazën Ajrore të NATO-s në Kuçovë

Rama e Peleshi: Shqipëria, vlerë e shtuar e Aleancës

Shndërrimi i Bazës Ajrore të Kuçovës në bazë ajrore të NATO-s, një mundësi e shkëlqyer për FA në ngritjen e kapaciteteve kombëtare dhe modernizimin e Forcës Ajrore



dhe më gjerë. Ndërtimi i kësaj baze në vendin tonë, është dhe mesazh i qartë që i dërgohet aktorëve të tjerë me qëllime jo-të mira në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Rritja e pranisë perëndimore në gjithë rajonin tonë nuk do të lejojë depërtimin dhe influencën e këtyre rivalëve, që kanë agjenda dhe interesa të tjera, të ndryshme nga ato që ne besojmë dhe ndajmë. Projekte dhe iniciativa të tjera si kjo e Kuçovës janë më se të mirëpritura në të ardhmen, dhe ne jemi besimplotë se zhvillime të tjera do të na ndjekin.”

- theksoi ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes tha më tej se me përfundimin e rikonstruksionit dhe vënien në gatishmëri operacionale, Baza Ajrore Taktike e Kuçovës do të luajë një rol vendimtar në mbështetjen e NATO-s dhe vendeve aleate për t'u dislokuar me shpejtësi dhe efikasitet. Por, sipas ministrit Peleshi baza do të ketë impakt pozitiv

edhe në fushën sociale dhe ekonomike për komunitetin që jeton pranë kësaj baze.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor, Prof. Asoc. Bajram Begaj, teksa e cilësoi një moment historik tha se: “Baza Ajrore Taktike e Kuçovës do të shndërrohet në një gjurmë të rëndësishme të prezencës së NATO-s dhe do të jetë në shërbim të stërvitjeve dhe operacioneve të ndryshme të Aleancës, duke qenë e gatshme 24 orë në 7 ditë të javës, si në kohë paqej, ashtu edhe në kohë krize”.

Investimi në këtë bazë arrin vlerën e rreth 45,8 milion euro dhe konsiston në ndërtimin e depove të armatimit, ato të karburantit, stacioneve të armatimit, parkingut të avionëve, stacionit kundër avarive dhe zjarreve, rindërtimin e pistës dhe kullës së kontrollit. Punimet parashikohet të përfundojnë në vjeshtën e vitit 2023.



CEREMONIA

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Respektoj kontributin jetësor të gjeneral Bitrit në Forcat e Armatosura

Në praninë e ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor, Prof. Asoc. Bajram Begaj, komandantëve të forcave dhe atyre mbështetëse, kolegëve dhe familjes së gjeneral brigade Bitrit, u zhvillua në Ministrinë e Mbrojtjes ceremonia e vendosjes së gradës. Në fjalën e tij ministri Peleshi u shpreh i gëzuar që në kuadër të procesit të promovimit të ushtarakëve me gradë madhore, Forcave të Armatosura dhe “trupës” së gjeneralëve të promovuar pak javë më parë i shtohet dhe një gjeneral brigade. “Ishte një promovim i merituar. Në kuadër të Aleancës apo dhe në kuadrin rajonal kemi rol të rëndësishëm për të luajtur. Për këtë na duhet dije, na duhet forcë e kompletuar dhe përgjegjshmëri. Njerëz si gjeneral Bitri vijnë në kohën e duhur, në vendin e duhur dhe në pozicionin e duhur. Respektoj kontributin jetësor të gjeneral Bitrit në Forcat e Armatosura dhe inkurajoj ushtarakët e tjerë, dhe



ata që tani rekrutohen, të shohin këtë rrugëtim të suksesshëm dhe të motivohen”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes. Gjeneral brigade Bitri duke ndarë emocionet me të pranishmit në ceremoni u shpreh: “Përfjetoj emocionet e një ëndrre tek e cila guxova të besoja. Nderin dhe privilegjin që më bëhet sot ia dedikoj një “liste” të gjatë njerëzish me të cilët më lidhin 36 vite në Forcat e Armatosura. Faleminderit atyre me të cilët kam punuar e punoj. Me kanë ndihmuar e mësuar të çmoj integritetin, virtytin dhe moralin. Faleminderit atyre për të cilët kam punuar e punoj. Kanë qenë e janë shembuj frymëzimi e lidhshëri. Më kanë dhënë besimin, më kanë mbështetur e ma kanë vlerësuar e për këtë ju jam edhe mirënjohës. Faleminderit familjes, në mënyrë të veçantë gjysmës time më të mirë Valbonës që ka sakrifikuar për të ma bërë më të lehtë punën, por dhe djalin dhe vajzën që megjithëse iu kam munguar më falin”.

**SHSHP të FA merr pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s****Gjeneralmajor Begaj: FA, angazhim maksimal për ndjekjen me interes të situatës në kufirin me Ukrainën**

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Begaj, mori pjesë në takimin virtual të Komitetit Ushtarak të NATO-s, në nivel shefash shtabi, i cili ishte i pari për vitin 2022.

Në hapjen e ditës së parë të takimeve, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admirali Bauer vlerësoi rëndësinë e këtij takimi sidomos për ambientin e sigurisë që NATO është duke u përballur.

“Jemi në një moment kyç për sigurinë tonë të përbashkët. Përpara takimit ministrot të muajit të ardhshëm dhe Samitit, është parësore që ju, shefat e Mbrojtjes, i dhatë këshilla ushtarake Këshillit të Atlantikut të Veriut për një mori temash, siç janë ato të parandalimit dhe mbrojtjes (Deterrence and Defence), kërkesat e ardhshme në epokën dixhitale, si dhe rritja e bashkëpunimit ushtarak me partnerët. Forca e Aleancës nuk qëndron vetëm në kohezionin dhe vendosmërinë tonë, por edhe në aftësinë për t’u përgatitur së bashku për të ardhmen”, - theksoi ai.

Shefat e Mbrojtjes së NATO u angazhuan më pas në diskutime me komandantin suprem të Aleatëve për Transformimin (SACT) gjeneralin Lavigne dhe komandantin suprem të Aleatëve për Europën (SACEUR) gjeneralin Wolters, mbi mundësitë ekzistuese dhe ato të reja për të mundësuar trupat, aftësitë dhe procedurat e NATO të përmbushin tre detyrat e saj kryesore në epokën dixhitale.

Në sesionet e tjera, shefat e Mbrojtjes u fokusuan në Mendimin Strategjik Ushtarak të Aleancës dhe mënyrën se si ai duhet të mbështesë konceptin e ri strategjik të NATO-s, zbatimin e konceptit të NATO-s për luftimin, ecurinë e konceptin për parandalimin dhe mbrojtjen e zonës euro-atlantike, parandalimin dhe qëndrimin e



mbrojtjes 360° të NATO-s, si dhe sesionin e dedikuar me partnerët, Ukrainën dhe Gjeorgjinë.

Gjeneralmajor Begaj në fjalën e tij shprehu falënderimin për SACEUR dhe SACT, duke theksuar mbështetjen e plotë për vlerësimin strategjik gjithëpërfshirës të tyre. Më tej, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-s shprehu angazhimin për ndjekjen me interes të situatës në kufirin me Ukrainën, por theksoi se një vëmendje e veçantë NATO

duhet të tregojë edhe për çështjet të situatës së sigurisë në krahun jugor të saj, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor.

Komiteti Ushtarak është përgjegjës për këshillimin e autoriteteve politike të NATO-s mbi masat që konsiderohen të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen e përbashkët të territorit të NATO-s, si dhe për zbatimin e vendimeve në lidhje me operacionet dhe misionet e NATO-s.

NATO një vëmendje të veçantë duhet të tregojë edhe për çështjet të situatës së sigurisë në krahun jugor të saj, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor

CERTIFIKOHEN 59 KURSANTË NË QAPN**Komandanti i QAPN, kolonel Toska: Arsimimi dhe trajnimi sa më cilësor është esencial**

Metoda bazë e përparimit dhe reformimit social, duke rritur kështu përfaqësimin dinjitoz në nivelin e performancës si ushtarakë dhe individë në shoqëri

Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e certifikimit të Kursit 50-të Bazë të Nënoficerit. Në këtë ceremoni morën pjesë Komandanti i QAPN-së, stafi i Komandantit, personel nga Dega e Administratës dhe Arsimimit, si dhe stafi instruktorë dhe mësimdhënës.

Gjatë ceremonisë përshëndetën Komandanti i QAPN-së, instruktori përgjegjës i kursit Bazë dhe kursantja e kursit bazë të nënoficerit, e cila përfundoi kursin me rezultate të larta. Në fjalën e tij përshëndetëse për kursantët Komandanti i QAPN-së, Kolonel Arben Toska, ndër të tjera shprehu se “Arsimimi dhe trajnimi juaj sa më cilësor është esencial, pasi është metoda bazë e përparimit dhe reformimit social, duke rritur kështu përfaqësimin dinjitoz në nivelin e performancës si ushtarakë dhe individë në shoqëri. Arsimimi është stafeta e profesionalizmit dhe mbrojtësi më i mirë i lirisë, më i mirë sesa një armatë këmbësorie, ndaj nuk ka investim më të rëndësishëm për ne sesa investimi në arsimim dhe dije”. Në këtë ceremoni u certifikuan 59 kursantë.



Emërohet komandanti i ri i Batalionit të II të Këmbësorisë, i FT

Batalioni i II i Këmbësorisë, i Forcës Tokësore (b2kFT) do të drejtohet nga nënkolonel Agim Kuçana.

Prezantimi në detyrë i komandantit të b2kFT, u bë nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji. Fillimisht, fjalën në ceremoni e mori komandanti në largim i b2kFT nënkolonel Dritan Muka, i cili pasi bëri një rezymë të punës dhe sfidave me të cilat u përball efektivi i batalionit, gjatë drejtimit nga ana e tij, falënderoi komandantin e Forcës Tokësore për mbështetjen e pakursyer që i dha repartit, në çdo kohë dhe çdo situatë. Një falënderim të veçantë nënkolonel Muka, adresoi për çdo efektiv të repartit për kontributin dhe angazhimin e tyre.

Ai e mbylli fjalën e tij duke i uruar nënkolonel Kuçanës, suksese në detyrën e komandantit të b2k, duke shprehur njëkohësisht edhe besimin e plotë, se me profesionalizmin që zotëron nënkolonel Kuçana do të arrijë të përballojë me sukses sfidën më të madhe për b2k, siç është certifikimi i Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL).

Nga ana e tij, nënkolonel Kuçana, falënderoi lidshpinin politik dhe ushtarak për besimin e treguar me emërimin e tij në detyrën e rëndësishme të komandantit të Batalionit të Dytë të Këmbësorisë. Ai shprehu gjithashtu mirënjohjen për ish-komandantin e b2k nënkolonel Muka, për drejtimin me profesionalizëm të repartit. “Unë besoj tek mrekullia që mund të sjellë puna dhe përkushtimi i secilit nga ju, por megjithatë unë besoj tek forca dhe angazhimi i të gjithë grupit, prandaj shpreh bindjen se të gjithë së bashku do ia dalim për të përmbushur këtë angazhim kaq të madh kombëtar siç është certifikimi i GBKL dhe të ngremë më lart emrin e këtij batalioni elitare.” , – u shpreh nënkolonel Kuçana.

Në vijim të ceremonisë, pjesëmarrësit u përshëndetën nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral Kingji, i cili fillimisht shprehu mirënjohjen dhe falënderimet për punën e bërë nga kom-

Nënkolonel Kuçana: Besoj tek mrekullia që mund të sjellë puna dhe përkushtimi i secilit

“Drejtimi i batalionit, vjen në një nga fazat më të rëndësishme në historinë e kësaj njësie, atë të certifikimit të Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL)”



andanti paraardhës i b2kFT nënkolonel Dritan Muka, në drejtim të këtij repartit të rëndësishëm të FT.

Më tej, duke vlerësuar nënkolonel Kuçanën, si një nga oficerët më me eksperiencë të Forcave të Armatosura, ai shprehu besimin se këtë eksperiencë dhe aftësitë profesionale të akumuluar ndër vite prej tij, ai do të dijë t'i verë në dispozicion të rritjes së nivelit të

përgatitjes së efektivëve të b2kFT.

“Drejtimi i batalionit, vjen në një nga fazat më të rëndësishme në historinë e kësaj njësie, atë të certifikimit të Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL), po ashtu në kuadër të ndryshimit në strukturë për t'iu përshatur kërkesave të certifikimit dhe projekteve në kuadrin e modernizimit në pajisje dhe strukturë. Për këtë arsye,

do të kërkoja nga secili nga ju ushtarë, oficerë dhe nënoficerë të b2k, të mbani lart ndjenjën e detyrës dhe të përkushtimit, për të realizuar të gjitha detyrat që rrjedhin nga misioni i b2k, si në kuadër kombëtar po ashtu edhe në detyrimet që kemi në kuadër të Aleancës.” , - tha ndër të tjera komandanti i Forcës Tokësore.

Nënkolonel Agim Kuçana, vjen

në këtë emërim të ri, pasi kreu me përkushtim dhe devotshmëri detyrën e zëvendëskomandantit të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS). Ai zotëron një background të admirueshëm si drejtues nënreparti dhe repartit, e ndërthurur kjo me eksperiencën në shtab, nga niveli i batalionit dhe deri në nivelin e oficerit të shtabit në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Forca Ajrore realizon iniciativën për mbjelljen e fidanëve të ullirit në ambientet e jashtme të Garnizonit Rinas



Në Garnizonin Rinas, edhe këtë fillim viti, personeli ushtarak dhe civil i Forcës Ajrore, ka realizuar iniciativën për mbjelljen e fidanëve të ullirit në mjediset e jashtme të Komandës.

Me një ceremoni të thjeshtë, në praninë e përfaqësuesve të Shtabit, komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj, përshëndeti efektivin duke i konsideruar këto nisma të vazhdueshme e të mirëpritura, sidomos për mjediset ku është e domosdoshme më shumë gjelbërim e më shumë oksigjen. Mbjellja e këtyre fidanëve të rinj, theksoi ai, përmban një simbolikë pozitive në këtë fillim viti për të gjithë strukturat e Forcës Ajrore, vit ky, i cili do të shoqërohet me një angazhim serioz në punë dhe plot energji e sfida të cilat do t'i përmbushim të gjithë së bashku.

Gjeneral Pulaj, përfundoi fjalën e tij me urimin për një vit sa më të mbarë në punë e në familje dhe më pas u vijua me mbjelljen e fidanëve të ullirit nga personeli i Komandës dhe Shtabit, Kompanisë së Mbështetjes duke shtuar gjelbërimin dhe treguar kujdesin ndaj mjedisit të punës ku punojmë dhe kontribuojmë përditë. Iniciativa e Forcës Ajrore për mbjelljen e ullinjve të rinj përkon me përkujtimin e 554-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, trashëgimi dhe simbolikë kjo qysh nga koha e Skënderbeut.



Basketbollist i ekipit të parë të Partizanit për 20 vjet, me 870 ndeshje në aktivitete kombëtare me 17.900 pikë të shënuara, në 120 ndeshje me 2760 pikë, me 17 kupa republike, pjesëmarrës 20 herë në kampionatet kombëtare

Gazmend Çaçi

legjenda e basketbollit në panteonin e yjeve të Partizanit

Intervistë me legjendën e basketbollit Gazmend Çaçi

INTERVISTOI:
ANJEZA MUSOLLARI

Gazmend Çaçi, basketbollist i ekipit të parë të Partizanit për 20 vjet, me 870 ndeshje në aktivitete kombëtare me 17.900 pikë të shënuara, në 120 ndeshje me 2760 pikë, me 17 kupa republike, pjesëmarrës 20 herë në kampionatet kombëtare, pjesëmarrës në edicionin e kupës së kampionëve, pjesëmarrës në lojërën olimpike të Barcelonës në vitin 1992, në kampionatin evropian, kampionatin ballkanik dhe në lojërën mesdhetare.

Me numrin 11 në fanellën e kuqe, me suksesin e punës së tij, legjenda Gazmend Çaçi vjen në një rrëfim të rrugëtimit disavjeçar për gazetën Ushtria.

Në çfarë moshe ka nisur dëshira për t'u marrë me këtë disiplinë sportive?

Shtëpia ime ndodhej shumë pranë "Shkollës së Bashkuar" dhe unë si një fëmijë kureshtar, qëndroja me orë të tëra pranë kangjellave, tek shihja të stërvitëshin në disiplina të ndryshme atletë që sot kanë bërë histori. Brenda këtij djaloshi po rritej një dëshirë e madhe për të qenë pjesë e tyre. Fillimisht u mora me atletikë, futboll dhe më pas me basketboll, duke parë që dhe shtatlartësia ime për moshën që kisha e kalonte normalen. Atë periudhë u afruan trajnerët të cilët më tërhoqën në ekipet e para të rinjve dhe të rinjve. Në moshën 13-14 vjeç u bëra pjesë e ekipit të para të rinjve të Partizanit.

Cila ka qenë ndeshja juaj e parë me ekipin e të rinjve?

Në ndeshjen time të parë me ekipin e të rinjve unë kam qenë rezerva e fundit në ndeshjen Partizani-Tirana, sepse sapo isha bërë pjesë e skuadrës ku Tirana në ato vite ishte kampione e të rinjve dhe ne luanim një finale ku shumë lojtarë të skuadrës tonë po dilnin jashtë me faull. Në këtë moment të vështirë trajneri, me besimin që nuk i mungonte tek unë dhe me kërkesën e tifozëve, më fut në lojë, rezultatin e të cilës e ktheva në favor të Partizanit. Theksoj se koshat i bënë

shokët e skuadrës, unë bëra mbrojtjen që solli fitoren. Ky ishte momenti kur trajneri të shprehej se "nga ky moment ky lojtar nuk do dalë më nga fusha e basketbollit".

Cili është emocioni që përshkon Gaz Çaçin në momentin kur ai fluturon mbi parketin e pallatit të sportit me topin në dorë?

Është një emocion që nuk e përshkruan dot me fjalë, sepse duhet të jesh pjesë e saj dhe ta dashurosh atë që po bën.

Kur e kuptuat përgjegjësinë që ju po luanit me një ekip kampion si partizani?

Këtë e kam kuptuar që në çastin e parë që u bëra pjesë e tij. Mua më ka mbështetur legjenda e sportit Petrit Muzaku, i cili më afroi me ekipin kampion. Por shumë shpejt trajneri i skuadrës gjatë seleksionimeve më nxjerr jashtë dhe unë u riktheva sërish në një admirues të basketbollit nga kangjellat e "Shkollës së Bashkuar" deri kur në vend të këtij trajneri erdhi trajner Muhamet Përmeti, i cili shikonte admirimin tim gjatë stërvitjes së shokëve dhe më thërrret për t'u ribashkuar me skuadrën e zezës. Trajneri i cili më ka ndjekur që nga para të rinjtë, të rinjtë dhe deri në



ekip të parë.

Cila është ajo ndeshje që ju e vlerësoni si historike?

Unë kam shumë ndeshje të mëdha, të kalibrave ndërkombëtare. Kemi luajtur me të gjitha skuadrat që kanë dalë kampion Europe, si Partizani i Beogradit, Bosnja, Banko di Roma, Italia-Skavolini, Skuikamtu, Aris-Selanikut.

Partizani i Beogradit ishte kampion bote, kampion Europe, në këtë kulm të tyre, ne na bie shorti të luajmë me ta dhe dolëm me rezultatin 100 me 97, çka ishte një arritje e madhe për ne, një diferencë kaq e vogël pikësh. Pra ne luanim me këto skuadra si të barabartë. Edhe pse këto merrnin lojtarë të huaj ne ishim me forcat tona. Një triumf i gjithi shqiptar.

Po ndeshja që zhgënjeu pritshmëritë tuaja?

Basketbolli është sport kolektiv dhe ndodh që jo të gjithë janë në formën e tyre më të mirë.

Kemi pasur ndeshje të dobëta si ajo me ekipin kombëtar Italian, dhe kjo si pasojë e çorganizimit tonë. Ishte koha kur në Shqipëri kushtet ekonomike linin për të dëshiruar dhe ne duke humbur në bukuritë e Italisë harruam ndeshjen dhe nuk u përkushtuam si në përballjet e tjera me ta, çka solli dhe fitoren e tyre me një diferencë prej 50 pikësh.

Kush janë trajnerët që punuan për rritjen profesionale të Gazmend Çaçit?

Mirënjohje dhe respekt pa kufi për disa prej trajnerëve të mi, që në fëmijërinë e hershme kur unë kam luajtur në fushat me bar dhe deri tek parketet e pallateve të sportit, si të



nderuarit trajnerë Sami Bushati, Lefi, Njazi Lleshi, Muhamet Përmeti, i cili punoi fort me mua për tre vitet që unë isha me ekipin e të rinjve. Më pas kalova në ekip të parë me trajnerët Qemal Shalsi dhe Astrit Greva.


Cilat janë pikat tuaja më të forta në basketboll?

Bashkëpunimi në grup, marrëdhënia njerëzore, stërvitja, guximi. Vlera që të bëjnë të shkëlqesh në një disiplinë sportive si basketbolli.

Po pika juaj më e dobët?

Sentimentalizmi, ndjeshmëria ndaj gjithçkaje që shoh se nuk shkon si duhet, altruizmi, që në të vërtetë janë

me njëri-tjetrin, shqetësoheshim për problemet më të vogla të çdo pjesëtari të ekipit, fitonim, humbim, ishin emocione që i kalonim me njëri-tjetrin, pra siç ndodh në familjet e vogla ashtu ndodhte dhe tek familja jonë e madhe. 6 muaj në vit ne ishim të grumbulluar, te partizani për takime ndërkombëtare, mbaronim ndeshjet ndërkombëtare me ekipin e Partizanit, grumbulloheshim dhe luanim ndeshjet ndërkombëtare me ekipin kombëtar. Ajo që më bën të ndihem keq është largësia që na ndodhi në fillimet e ndryshimeve politike në Shqipëri. Edhe pse unë kam organizuar aktivitete për t'u bashkuar me miqtë e mi, ka qenë gati e pamundur të bashkoj atë familje të madhe të dikurshme.



vlera tek njeriu, por unë vetes ia shoh si dobësi në raport me të tjerët.

Si kanë qenë raportet tuaja me pjesëtarët e tjerë të ekipit?

Ne ishim një familje. Ne gëzonim

Cilët kanë qenë rivalët tuaj në ekipet e tjera me të cilët keni pasur duela të forta por dhe emocionuese?

Ekipi i basketbollit i Shkodrës ka qenë një nga rivalet tanë, sepse në këndvështrimin tim ka qenë një skuadër



e fuqishme, por çudia jonë ishte se ne fitonim në Shkodër më lehtë se në Tiranë, me një diferencë prej 10-15 pikësh në favor të Partizanit.

Jo më pak rivalitet kishim dhe me Tiranën, Dinamon.

Ndërsa për ndërkombëtarët do të përmendja skuadrat e Jugosllavisë, të atyre viteve që ishin kampion bote, skuadrat Italiane, franceze, çeke e cila ishte në vendin e tretë në kampionatin botëror e me të cilët kemi dalë shpesh kampion, siç ishte dhe rasti i përballjes me Greqinë e atyre viteve, kampion bote, ne triumfuam edhe pse në përbërjen e tyre këto skuadra kishin lojtarë të

NBA-së.

Çfarë do të thotë të largohesh nga një dashuri e madhe si basketbolli?

Dashuritë nuk braktisen. Unë jam rritur me këtë ndjesi ndaj punova fort për të arritur qëllimin tim në jetë. Sot nuk jam më pjesë e ekipeve por vazhdoj të përçoj tek brezat e rinj dashurinë për basketbollin.

Z. Çaçi, si do e përshkruanit me një fjali basketbollin në kohën e shkëlqimit tuaj, dhe si është ai sot?

Nuk jam me mendimin se atëherë kishte basketboll dhe sot jo, jemi në

kohëra të ndryshme, ne atëherë nuk kishim kushtet që kanë sot skuadrat, ne stërviteshim gjithë vitin për një ndeshje ndërkombëtare, ne stërviteshim 7-8 orë në ditë kurse sot maksimumi 2 orë, mungon motivimi, pasioni. Ajo që vë re tek të rinjtë sot, edhe pse me kaq pak angazhim, i kuptojnë gjërat më shpejt sesa ne, por kanë papërgjegjshmëri dhe nuk e dashurojnë atë që bëjnë. Nëse shënon kosh, si shumë idhuj të kohëve moderne Kobe Bryant apo Stephen Curry, për të rinjtë sot është arritje, por në të vërtetë basketbolli është art, është balet, është përplasje trup me trup, është fantazi pa të cilën basketbolli nuk mund të arrijë asgjë në këtë disiplinë sportive.

Sot në kampionatin shqiptar po luajnë shumë basketbollistë të huaj, a e shikoni këtë fenomen si pengesë për rritjen e lojtarëve vendas?

Personalisht e shoh si një proces negativ, sepse deri në momentin që merr 2 apo dhe 3 lojtarë të huaj e quajmë pozitive sepse sjell eksperiencë të reja në skuadër, por kur kjo shkon në 8 lojtarë të huaj kjo skuadër nuk është më shqiptare pra kemi humbur identitetin.

A kishit ju një idhull të cilit do të donit t'i ngjanit?

Ka pasur super yje në Europë dhe Amerikë, të cilët i ndiqja me kërshtëri të madhe dhe i adhuroja për spektaklin që jepnin në ndeshjet e tyre. Jam adhures i artit të Kobe Bryant.

Cili është momenti kyç të cilin doni ta veçonit nga karriera juaj?

Një karrierë e gjatë me ulje-ngritje e veta, me kërkesat e mija ndaj asaj që doja të arrija, shpesh herë më bënte të mos gëzoja rezultatet e suksesshme. 25 vite karrierë kanë pasur veçantitë e tyre sepse çdo ndeshje kishte surprizat e saj, por po kujtoj njëherë, eliminatorët e kampionatit europian, ku luanin 7 skuadra europiane dhe unë dola kohëshënuesi më i mirë i asaj eliminatorjeje.

Sot përveçse një legjendë në historinë e sportit shqiptar jeni dhe gjysh, po ndikoni që pasardhësit tuaj të ndjekin gjurmët ku denjësisht keni ecur?

Djali im merret me basketboll, në fëmijërinë e tyre dhe dy vajzat e mija, por më pas u larguan për të gjetur veten e tyre aty ku ndihen më mirë. Tani jam gjysh i tre nipërve dhe dy mbesave. Tek të pestë e shoh nga pak veten time, por kjo i mbetet së ardhmes.

Prej vitesh jeni pjesë e strukturave të Forcave të Armatosura si Shef i Sektorit të Aktiviteteve pranë QKMBMFA, si është të punosh me njerëzit në uniformë?

Unë jam rritur në këto ambiente dhe ruaj një respekt të pakufi për njerëzit që punojnë dhe sakrifikojnë jetën e tyre. Shumë prej sportistëve elite kanë dalë pikërisht prej strukturave të Forcave të Armatosura. Kënaqësi që jam pjesë e tyre në formatin e organizatorit të aktiviteteve sportive.

Aleanca e gatshme të vazhdojë dialogun me Rusinë

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg falënderoi kancelarin gjerman Olaf Scholz për angazhimin e tij të fortë personal ndaj NATO-s dhe rolit udhëheqës të Gjermanisë në Aleancë gjatë një vizite në Berlin më 18 janar 2022. Duke folur në konferencën për shtyp së bashku me kancelarin gjerman, Sekretari i Përgjithshëm theksoi se NATO është e gatshme të vazhdojë dialogun me Rusinë, por nuk do të bëjë kompromis mbi parimet thelbësore për sigurinë europiane. Zoti Stoltenberg paralajmëroi se rreziku i konfliktit në Europë mbetet real për shkak të ngritjes së vazhdueshme ushtarake të Rusisë, të pashpjegueshme dhe të pajustificuar, brenda dhe rreth Ukrainës. “Aleatët e NATO-s i bëjnë thirrje Rusisë të de-përshkallëzojë”, -tha zoti Stoltenberg dhe se “Çdo agresion i mëtejshëm do të ketë një kosto të lartë për Moskën.”

Sekretari i Përgjithshëm e bëri të qartë se NATO është e gatshme të vazhdojë dialogun me Rusinë. “Kam ftuar sot të gjithë anëtarët e Këshillit NATO-Rusi në një sërë takimesh”, -tha z. Stoltenberg. Ai shtoi se aleatët janë të përgatitur të shikojnë një sërë çështjesh me Rusinë, duke përfshirë forcimin e linjave të komunikimit ushtarak dhe civil, reduktimin e rreziqeve dhe rritjen e transparencës në lidhje me aktivitetet ushtarake, si dhe reduktimin e hapësirës dhe kërcënimeve kibernetike. “Ne jemi gjithashtu të përgatitur të rifillojmë shkëmbimin e informimeve mbi stërvitjet, dhe për politikën tona përkatëse bërthamore dhe aleatët janë të përgatitur të diskutojnë kontrollin e armëve, çarmatimin dhe mospërhapjen”, -tha Sekretari i Përgjithshëm. Në të njëjtën kohë, z. Stoltenberg përsëriti se çdo komb ka të drejtë të zgjedhë rrugën e tij dhe se NATO do të vazhdojë të mbrojë aleatët e saj. “Kur tensionet janë të larta, dialogu është edhe më i rëndësishëm”, -tha Sekretari i Përgjithshëm, duke shtuar se aleatët do të bëjnë çdo përpjekje për të gjetur një rrugë politike përpara. Gjatë vizitës së tij në Berlin, Sekretari i Përgjithshëm u takua gjithashtu me Ministren e Mbrojtjes së Gjermanisë Christine Lambrecht dhe mori pjesë në një panel diskutimi të organizuar nga Fondacioni Körber së bashku me revistën Der Spiegel.

Rreziku i konfliktit është real

Në konferencën për shtyp që Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg dha së bashku me kancelarin e Gjermanisë, Olaf Scholz, Stoltenberg falënderoi Gjermaninë për angazhimin e fortë në NATO dhe falënderoi veçanërisht kancelarin i ri për përkushtimin e fortë personal ndaj NATO-s.

“Sot, ne trajtuam vendosjen ushtarake të Rusisë në dhe rreth Ukrainës, dhe implikimet për sigurinë europiane. Rreziku i konfliktit është real”, -iu tha ai medieve. Aleatët e NATO-s i bëjnë thirrje Rusisë të de-përshkallëzojë dhe se çdo agresion i mëtejshëm do të ketë një kosto të lartë për Moskën. NATO është një Aleancë mbrojtëse, e cila nuk kërcënon Rusinë apo ndonjë vend tjetër. Ne mbetemi të përkushtuar ndaj qasjes sonë të dyfishtë: parandalim dhe mbrojtje të fortë, të kombinuara me dialog”, -theksoi ai. “Aleatët e NATO-s janë të përgatitur të shikojnë se si mund të forcojmë linjat e komunikimit ushtarak dhe civil. Ne gjithashtu inkurajojmë Rusinë që të ndryshojë vendimin e saj

Stoltenberg: NATO nuk do të bëjë kompromis mbi parimet thelbësore për sigurinë europiane

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe kancelari gjerman diskutojnë grumbullimin ushtarak të Rusisë



për të ndërprerë marrëdhëniet diplomatike me NATO-n. Ne duhet të trajtojmë gjithashtu sigurinë europiane, jo më pak situatën në dhe rreth Ukrainës. Aleatët e NATO-s janë gjithashtu të përgatitur të diskutojnë propozime konkrete se si të reduktohen rreziqet dhe të rritet transparenca në lidhje me aktivitetet ushtarake dhe se si të reduktojmë hapësirën dhe kërcënimet kibernetike. Ne jemi gjithashtu të përgatitur të rifillojmë shkëmbimin e informimeve mbi stërvitjet dhe politikën tona përkatëse bërthamore. Por nga ana tjetër aleatët janë të përgatitur të diskutojnë kontrollin e armëve, çarmatimin dhe mospërhapjen dhe inkurajojnë Rusinë që të angazhohet seriozisht në reduktimin e kërcënimit nga armët bërthamore dhe sistemet raketore. Kështu që NATO është gati dhe aleatët e NATO-s janë gati të angazhohen dhe të dëgjojnë shqetësimet që mund të ketë Rusia. Por ne nuk do të bëjmë kompromis mbi parimet thelbësore. Të tilla si e drejta që çdo komb të zgjedhë rrugën e vet dhe aftësia e NATO-s për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë aleatët.”, -tha shefi i NATO-s.

Ndërkohë NATO është e paqartë për perspektivat e përparimit, por kur tensionet janë të larta, dialogu është edhe më i rëndësishëm dhe aleatët e NATO-s do të bëjnë çdo përpjekje për të gjetur një rrugë politike përpara”, -tha Jens Stoltenberg dhe përshëndeti gjithashtu bisedimet dypalëshe midis Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë dhe diskutimet në OSBE.

Të përkushtuar ndaj qasjes të dyfishtë, parandalim dhe mbrojtje, e kombinuar me dialog

Gjatë vizitës së tij në Berlin, më 18 janar 2022, Sekretari i Përgjithshëm u takua gjithashtu me ministren e Mbrojtjes së Gjermanisë Christine Lambrecht dhe mori pjesë në një panel diskutimi të organizuar nga Fondacioni Körber së bashku me revistën Der Spiegel.

Edhe pas takimit me ministren e Mbrojtjes, Christine Lambrecht, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg dha një deklaratë për shtypin ku theksoi për angazhimin e fortë personal të ministres Lambrecht ndaj NATO-s, ndaj Aleancës euro-atlantike, si dhe për kontributet e Gjermanisë për sigurinë tonë të përbashkët, për mbrojtjen tonë kolektive në mënyra të ndryshme.”, -tha ai. “Ju ndani dhe drejtoni grupin luftarak të NATO-s në Lituani dhe unë e mirëpres faktin që ju shkuar atje si udhëtimi juaj i parë jashtë vendit, duke demonstruar angazhimin tuaj personal, si për Bundeswehr-in, por edhe për praninë e NATO-s në rajonin e Balltikut. Kam takuar personel gjerman në shumë misione dhe operacione të ndryshme. Përfshirë në Lituani, por edhe në Kosovë dhe mbi aktivitetet detare për shembull në detin Egje. Dhe gjithmonë më bën përshtypje profesionalizmi, përkushtimi i ushtarëve gjermanë, burra e gra me uniformë në misione dhe operacione të ndryshme të NATO-s.”, -tha Sekretari i Përgjithshëm dhe theksoi kontributin

e Gjermanisë në NATO. “E gjithë kjo është një shenjë e fortë e solidaritetit të NATO-s. Dhe kjo është edhe më e rëndësishme tani pasi kemi një kohë kritike për sigurinë europiane. Me vendosjen e ushtrisë ruse në Ukrainë dhe rreth saj, me retorikën kërcënuese dhe gjithashtu me historinë ruse të përdorimit të forcës kundër Ukrainës më parë”, -tha Stoltenberg. Sot i kam ftuar të gjithë anëtarët e Këshillit NATO-Rusi

të takohen sërish në një sërë takimesh për të adresuar çështje të rëndësishme për sigurinë tonë. Transparenca mbi aktivitetet ushtarake, mekanizmat për reduktimin e rreziqeve, si dhe kontrollin e armëve dhe linjat e komunikimit, duke theksuar mbështetjen te Gjermania. Dhe e di që mund të mbështetem te Gjermania dhe te ju personalisht kur bëhet fjalë për të dyja: parandalimin, mbrojtjen dhe dialogun.”, -përfundoi Jens Stoltenberg.

Danimarka rinovon kontributin e saj në policimin ajror të NATO-s në rajonin e Baltikut

Danimarka po përgatit katër prej avionëve të saj luftarakë F-16 për një dislokim të ri në Lituani në mbështetje të misionit të zgjeruar të policisë ajrore të NATO-s në shtetet baltike. “Ne mirëpresim vendimin e Danimarkës për të ofruar avionë luftarakë shtesë për misionin e policisë ajrore të NATO-s në shtetet baltike”, -tha zëvendës zëdhënësi i NATO-s, Piers Cazalet. “Ky është një kontribut thelbësor për mbrojtjen tonë kolektive dhe një shfaqje e fortë e kontributit të rëndësishëm të Danimarkës në Sigurinë e Aleancës. Siç e ka bërë të qartë Danimarka, ky dislokim vjen në kontekstin e krizës aktuale të shkaktuar nga forcimi i vazhdueshëm ushtarak i Rusisë në dhe afër Ukrainës. Ne mbetemi gjithmonë vigjilentë”, -shtoi ai. Avionët dhe deri në 70 personel do të operojnë jashtë bazës ajrore Šiauliai. Të kontrolluar nga Qendra e Operacioneve të Kombinuara Ajrore (CAOC) Udem, avionët do të fluturojnë duke mbrojtur hapësirën ajrore mbi Estoninë, Letoninë dhe Lituani. F-16-të danezë do t'i bashkohen F-16-ve polakë dhe belgë në rajon dhe do t'i ofrojnë NATO-s një aftësi të përmirësuar të policisë ajrore për të përbushur misionin e qëndrueshëm dhe për të siguruar parandalimin dhe mbrojtjen në krahun verilindor të NATO-s. Ndërkohë që misioni fillestar i policisë ajrore baltike i NATO-s filloi me një detashment luftarak në Lituani në 2004, Aleanca prezantoi Policimin Ajror të përmirësuar në 2014 duke rritur aftësinë mbrojtëse deri në tre shkëputje shtesë që fluturonin jashtë Estonisë, Litanisë dhe Polonisë. Komanda Ajrore Aleate në Ramstein, Gjermani, mbikëqyr misionin dhe kontributet e ndryshme kombëtare kontrollohen dhe menaxhohen taktikisht nga CAOC veriore e Aleancës. Policia ajrore e NATO-s është një mision në kohë paqeje, i cili synon të ruajë sigurinë e hapësirës ajrore të Aleancës. Është një detyrë kolektive dhe përfshin praninë e vazhdueshme – 24 orë në ditë, 365 ditë në vit – të avionëve luftarakë dhe ekipazheve, të cilët janë të gatshëm të reagojnë shpejt ndaj shkeljeve të mundshme të hapësirës ajrore. Komandanti Suprem i Aleatëve në Europë (SACEUR) është përgjegjës për kryerjen e misionit të policisë ajrore të NATO-s. Ruajtja e integritetit të hapësirës ajrore të NATO-s është një nga misionet e Mbrojtjes së Integruar Ajrore dhe Raketore të NATO-s.

AGJENCIA E NATO-S E KOMUNIKIMEVE DHE INFORMACIONIT (NCI)

NATO dhe Ukraina riafirmojnë angazhimin për bashkëpunim teknik

Agjencia e NATO-s e Komunikimeve dhe Informacionit (NCI) dhe Ukraina nënshkruan më 17 janar 2022 një Memorandum Marrëveshjeje të rinovuar për të vazhduar punën e tyre së bashku në projektet e lidhura me teknologjinë. Ambasadorja Nataliia Galibarenko, Shefi i Misionit të Ukrainës në NATO dhe Ludwig Decamps, Menaxher i Përgjithshëm i Agjencisë së Komunikimit dhe Informacionit të NATO-s rinovuan Memorandumin e Marrëveshjes për të bashkëpunuar në projekte të lidhura me teknologjinë. “Sipas kësaj marrëveshjeje të rinovuar, ne do të thellojmë bashkëpunimin tonë me Ukrainën për t’i mbështetur ato në modernizimin e teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve të komunikimit, duke identifikuar fushat ku mund të kërkohet trajnim për personelin e tyre. Ekspertët tanë janë të gatshëm për të vazhduar këtë partneritet kritik.” - tha Menaxheri i Përgjithshëm i Agjencisë NCI, Ludwig Decamps.

Marrëdhëniet midis NATO-s dhe Ukrainës datojnë në fillim të viteve 1990. Bashkëpunimi është thelluar me kalimin e kohës dhe është reciprokisht i dobishëm, me Ukrainën që kontribuon në mënyrë aktive në operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO. Që kur Bordi Mbikëqyrës i Agjencisë miratoi marrëveshjen e parë në vitin 2015, Agjencia ka mbështetur vazhdimisht Ukrainën për çështjet e teknologjisë, kryesisht përmes Fondit të Mirëbesimit të Komandës, Kontrollit, Komunikimit dhe Kompjuterëve NATO-Ukrainë (C4).

“Memorandumi i nënshkruar sot vazhdon bashkëpunimin tonë të krijuar në vitin 2015. Me mbështetjen e NATO-s ne planifikojmë të futim më tej teknologjitë dhe shërbimet moderne të informacionit në sistemin e komandës dhe kontrollit të Forcave të Armatosura të Ukrainës,” tha ambasadorja Nataliia Galibarenko, shefe e Misionit të Ukrainës në NATO. Projektet përfshijnë një përpjekje për të ofruar pajisje të sigurta komunikimi në Ukrainë në dhjetor 2018, të cilat janë ende në përdorim sot. Programi Rajonal i Sigurisë së Hapësirës Ajrore NATO-Ukrainë (RASP) u zhvillua gjithashtu në bazë të kësaj marrëveshjeje, për të ofruar njoftim dhe koordinim të hershëm mbi kërcënimet e hapësirës ajrore. Sistemi përfshin një sistem të integruar telefoni IP dhe ofron mjete për operatorët për t’i ndihmuar ata të ndërveprojnë me njëri-tjetrin, të tilla si biseda, tregues gjeografikë dhe theksimi i një piste avioni. Njësitë janë të lidhura nëpërmjet një rrjeti të dedikuar të veçantë nga Interneti.

RASP lejon ndarjen e fotografive ajrore nga radarët dhe koordinimin e drejtpërdrejtë të operatorit me operatorin. Njësitë janë të lidhura nëpërmjet një rrjeti të dedikuar të veçantë nga Interneti. Puna me Ukrainën përfshin gjithashtu një Iniciativë për Ndarjen e Njohurive ku ekspertët e Agjencisë ndajnë njohuritë e tyre për praktikatat e NATO-s në zhvillimin e aftësive në fushën e Komandës, Kontrollit, Komunikimit dhe Kompjuterëve (C4).



Takimi i Shefave të Mbrojtjes të NATO-s

Më 12 dhe 13 janar 2022, 30 shefat e Mbrojtjes së aleatëve zhvilluan takimin e parë të planifikuar në këtë format. Dita e parë e sesioneve u fokusua në Mendimin Strategjik Ushtarak si dhe kërkesat dhe aftësitë ushtarake.

Në hapjen e ditës së parë të takimeve, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admirali Bauer priti të 30 shefat e Mbrojtjes në takimin e parë në këtë format të vitit 2022. “Jemi në një moment kyç për sigurinë tonë të përbashkët. Përpara takimit ministrot të muajit të ardhshëm dhe samitit të ardhshëm, është parësore që ju, shefat e mbrojtjes i dhatë këshilla të pakufizuara ushtarake Këshillit të Atlantikut të Veriut për një mori temash, duke filluar nga Parandalimi dhe Qëndrimi ynë aktual i Mbrojtjes, deri te kërkesat tona të ardhshme në epoka dixhitale, si dhe rritja e bashkëpunimit tonë ushtarak me Partnerët. Forca jonë si Aleancë nuk qëndron vetëm në kohezionin dhe vendosmërinë tonë, por edhe në aftësinë tonë për t’u përgatitur së bashku për të ardhmen dhe të papriturën”, -theksoi ai.

Në konferencën për shtyp pas seancës së Komitetit Ushtarak me 30 Shefat e Mbrojtjes, Admirali Rob Bauer, Kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s njoftoi se do të mbahen edhe dy konferenca të tjera këtë vit, në maj dhe shtator. Këto takime ofrojnë një mundësi që Autoriteti më i Lartë Ushtarak i NATO-s të bashkohet, për të vlerësuar situatën aktuale të sigurisë, për të diskutuar çështjet e vazhdueshme të punës dhe për të reflektuar mbi kërkesat e ardhshme. Për gati 73 vjet, NATO ka mbetur Aleanca më e fortë ushtarake në botë përmes aftësisë së saj për t’u përshtatur, për të pritur të papriturën dhe për t’u përgatitur për të. Në klimën e sotme të sigurisë, NATO po përballon me grupin më kompleks të sfidave në një brez; Rusia është më agresive jashtë vendit dhe më shtypëse brenda”, -tha ai. Shefat e Mbrojtjes të NATO-s u angazhuan më pas në diskutime me Komandantin Suprem të Aleatëve për Transformimin, gjeneralin Lavigne dhe Komandantin Suprem të Aleatëve për Europën, gjeneralin Wolters, mbi mundësitë ekzistuese dhe potenciale të reja për të mundësuar trupat, aftësitë dhe procedurat e NATO-s të përmbushin tre detyrat e saj kryesore

Shefat ushtarakë të NATO-s diskutojnë mbrojtjen euro-atlantike

Admirali Bauer: Jemi në një moment kyç për sigurinë tonë të përbashkët



në fushën epokës dixhitale. “Në NATO, ne jemi shumë të vetëdijshëm për sfidat dhe mundësitë që ofron epoka dixhitale dhe jemi të angazhuar në mënyrë aktive në një transformim dixhital të mënyrave tona të punës, pajisjeve tona dhe burimeve tona njerëzore. Tani duhet t’i përkthejmë këto mundësi në procese aktuale që do të na mundësojnë të mbështesim më mirë komandantët tanë në det, në tokë, në ajër dhe ata që punojnë në fushën kibernetike dhe hapësirë”, -sqaroi Admirali Bauer.

Në sesionin e fundit të ditës, Shefat e Mbrojtjes së Aleatëve u fokusuan në Mendimin Strategjik Ushtarak të Aleancës dhe mënyrën se si ai duhet të ushqehet me Konceptin e ri Strategjik të NATO-s. Ata u informuan gjithashtu mbi zbatimin e Konceptit të NATO-s për Kapitullin Luftimi, si dhe përparimin në Konceptin për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Zonës Euro-Atlantike.

Kurse më 13 janar 2022, shefat e mbrojtjes së NATO-s filluan ditën e

dytë të takimeve me një dialog me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, i cili parashtroi prioritetet dhe perspektivat e tij për situatën e sigurisë. Sesioni tjetër i ditës u fokusua në mjedisin aktual të sigurisë globale dhe qëndrimin e vazhdueshëm të parandalimit dhe mbrojtjes të NATO-s.

Shefat e Mbrojtjes u takuan gjithashtu me partnerin e tyre ukrainas, gjeneralin Zoluzhnyi, i cili i informoi ata mbi situatën aktuale të sigurisë në dhe rreth vendit të tij, si dhe zhvillimet në reformat e tyre të vazhdueshme të mbrojtjes. Më vonë, partneri i tyre gjergjian, gjeneralmajor Matiashevili shpjegoi reformat dhe aftësitë e reja mbrojtëse të zhvilluara përmes Paketës Substanciale NATO-Gjeorgji. Kjo ishte hera e parë që Komiteti Ushtarak u takua në Sesionin e Shefave të Mbrojtjes për vitin 2022. Ndërkohë ka një takim të dytë të planifikuar në maj në selinë e NATO-s në Bruksel dhe një tjetër më vonë këtë vit në një shtet anëtar.



Staf nga Universiteti “Sultan Qaboos” i Omanit viziton selinë e NATO-s

Më 4-5 janar 2022, një grup studentësh dhe anëtarësh të fakultetit nga Programi i Studimeve për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studimeve të Sigurisë të Universitetit “Sultan Qaboos” të Omanit vizituan selinë e NATO-s, për një seminar dyditor në kuadër të përpjekjeve të diplomacisë publike të NATO-s.

Grupi u takua me Javier Colomina, Zëvendës Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm për Çështjet Politike dhe Politikën e Sigurisë, për të diskutuar prioritetet aktuale të NATO-s në drejtim të Samitit të Madridit në qershor 2022.

Ata u informuan gjithashtu për NATO 2030 dhe rrugën përpara për Aleancën; Koncepti Strategjik i së ardhmes; Bashkëpunimi i NATO-s me partnerët në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, përfshirë Gjirin; qasja e Aleancës ndaj kundër-terrorizmit; Qëndrimi i NATO-s ndaj Kinës; dhe operacionet dhe misionet e NATO-s, përfshirë misionin e NATO-s në Irak. Grupi vizitoi gjithashtu Qendrën Euro-Atlantike të Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive (EADRCC) në selinë e NATO-s.

Omani, një shtet anëtar i Këshillit të Bashkëpunimit të Gjirit, ka një ftesë në priti për t’u bashkuar me Nismën e Bashkëpunimit të NATO-s në Stamboll (ICI) dhe merr pjesë në aktivitete ad-hoc, veçanërisht në Qendrën Rajonale NATO-ICI në Kuvajt.

Në përkujtim të 554-vjetorit të vdekjes së heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeu

GJERGJ KASTRIOT SKËNDERBEU, identiteti ynë kombëtar, e shkuara e lavdishme dhe rruga e të nesërmes për shqiptarët!

Kryezoti Kastriot është udhërrëfyesi ynë në ëndrrën për liri, për bashkim dhe shtet-formim, është prova që na tregon si kemi qenë dhe shenja që na dëshmon si duhet të jemi!

Luftëtari gjenial, ambasador i fjalës dhe diplomat i forcës, i dha Shqipërisë së djeshme dhe të nesërme adresën e pandryshueshme europiane të identitetit, të përkatësisë dhe të frymëzimit nga historia dhe kultura. Kastrioti ynë na dha emrin! Na bëri shqiptarë të Europës dhe Europën e bëri flamur të Shqipërisë!

Lirinë nuk ua solla unë, atë e gjeta mes jush! Sapo më shkeli këmba truallin tuaj, sapo dëgjua emrin tim, mu derdhët me vrap të gjithë, me dolët përpara kush e kush më parë, sikur të kishit dëgjuar që u ngritën nga varret etërit, vëllezërit, bijtë tuaj, sikur të kishin zbritur këtu gjithë perënditë.... Armët nuk ua solla unë, por ju gjeta të armatosur! Lirinë e pashë se e keni kudo, në kraharor, në ballë, në shpatat e në ushtat”.

Tri herë qyteti i Krujës, që ishte dhe qendra e Skënderbeut, u rrethua nga ushtritë osmane. Dy herë nga sulltanët dhe një herë nga gjenerali më i lartë turk, Evrenoz Pasha.

“Skënderbeu me forca dhe me ushtri të fuqishme e sulmonte çdo ditë ushtrinë e Mehmetit dhe nuk i linte për asnjë çast të qetë...lëshohej pa pushim mbi të, si një përrua që zbret nga malet pas shirave të mëdha dhe përmbytëse dhe që rrëmben çdo gjë me vete, po ashtu edhe Skënderbeu lëshohej pa pushim herë nga njëra anë, herë nga ana tjetër, e trondiste atë kudo, i shkaktoante armikut vrasje, dëme dhe humbje shumë të mëdha”.

“(Beteja e Byshekut). Shqiptarët e ndezën zjarrin e luftës, morën në duart e tyre ushtat, të cilat u ngjanin gjarpërinjve helmues dhe qëndruan në grykat e shpellave. Ata luftuan deri kur erdhi koha e mbrëmjes... kur lufta pushoi, ata u grumbulluan të gjithë në një vend dhe në mëngjes dolën si një lumë nga lugina dhe u vërsulën menjëherë mbi ushtrinë e Anadollit”.

Ibn Kemal, historian osman: “Sulltani, pasi urdhëroi ushtarët që të grabisnin e të plaçkitnin,...la maleve pjesën më të madhe dhe më luftarake të ushtrisë... kurse ai, duke qëndruar bashkë me pjesën tjetër të ushtrisë, plaçkiste vise të tëra të vendit”. Kritubuli, historian bizantin: “Aftësitë e Skënderbeut si burrë shteti spikatën edhe në marrëdhëniet me vendet e tjera. Ai e vlerësoi drejt rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar, si kusht i nevojshëm për të përballuar agresionin osman. Duke pasur të qartë se rrezikun osman mund t'i bëhej ballë me sukses vetëm me forca të bashkuara, Skënderbeu iu drejtua pareshur shteteve europiane dhe kërkoi pjesëmarrjen e tyre në luftën kundër armikut të përbashkët, si dhe përkrahje materiale për luftën e popullit shqiptar.

Personaliteti i Skënderbeut si burrë shteti, strateg e mjeshtrë i artit ushtarak dallonte me mbretërit e me princat europianë të kohës. Ndryshe nga veprimtaria ushtarake e tyre, që bazohej mbi trupat mercenare të armatosura rëndë, Skënderbeu u mbështet mbi një ushtri të armatosur lehtë, me lëvizshmëri të madhe e aftësi të lartë goditëse, të formuar kryesisht nga vullnetarë që kishin gatishmëri luftarake dhe shpirt vetëmohimi. Edhe ai vetë luftonte i pangarkuar me armatime të rënda e



Në kushtet e pabarazisë, Skënderbeu përpunoi strategjinë dhe taktikën e tij ushtarake, në bazë të së cilës qëndronte mendimi se fitorja nuk mund të varej nga numri i ushtarëve.

Këtë parim, të ndjekur prej tij, e shprehin me vërtetësi edhe fjalët që Barleti ka vënë në gojë të Skënderbeut, se “Kush nuk është në gjendje ta mundë armikun me një ushtri prej 8 deri 12 mijë vetash, nuk do të mund ta bënte këtë edhe me një ushtri shumë më të madhe”. Aftësitë e Skënderbeut si burrë shteti spikatën edhe në marrëdhëniet me vendet e tjera. Ai e vlerësoi drejt rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar, si kusht i nevojshëm për të përballuar agresionin osman. Duke pasur të qartë se rrezikun osman mund t'i bëhej ballë me sukses vetëm me forca të bashkuara, Skënderbeu iu drejtua pareshur shteteve europiane dhe kërkoi pjesëmarrjen e tyre në luftën kundër armikut të përbashkët, si dhe përkrahje materiale për luftën e popullit shqiptar.

Personaliteti i Skënderbeut si burrë shteti, strateg e mjeshtrë i artit ushtarak dallonte me mbretërit e me princat europianë të kohës. Ndryshe nga veprimtaria ushtarake e tyre, që bazohej mbi trupat mercenare të armatosura rëndë, Skënderbeu u mbështet mbi një ushtri të armatosur lehtë, me lëvizshmëri të madhe e aftësi të lartë goditëse, të formuar kryesisht nga vullnetarë që kishin gatishmëri luftarake dhe shpirt vetëmohimi. Edhe ai vetë luftonte i pangarkuar me armatime të rënda e

me krah të shpërvjelur si një ushtar i zakonshëm. Në betejë ai ishte, në të njëjtën kohë, komandant i talentuar dhe ushtar i guximshëm, që me shembullin e tij bëhej burim frymëzimi për luftëtarët shqiptarë. Edhe në jetën e përditshme Skënderbeu ishte i thjeshtë dhe kohën e kalonte kryesisht me bashkëluftëtarët e tij, duke bërë jetë ushtari.

Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, ishte përfaqësuesi më konsekuent dhe më i shquar i elitës drejtuese shqiptare, që udhëhoqi më vendosmëri frontin e luftës së shqiptarëve kundër pushtuesve osmanë. Ai realizoi të parin bashkim të shqiptarëve, Lidhjen Shqiptare të Lezhës, e cila hapi rrugën e krijimit të shtetit të pavarur shqiptar, themeluesi i të cilit u bë ai vetë. Kujdes të veçantë Skënderbeu i kushtoi ruajtjes së burimeve të brendshme ekonomike, tek të cilat u mbështet lufta, duke fuqizuar mbrojtjen në brezin kufitar, në lindje e në jug, ai i dha mundësi banorëve të viseve të lira të zhvillonin një veprimtari ekonomike deri diku normale.

Pjesëmarrja e gjerë e shqiptarëve në ushtrinë e Skënderbeut la gjurmët e veta në taktikën dhe armatimin e saj.. Në çdo luftim Skënderbeu përqijë ta parashikonte ecurinë e tij, sulmonte e hapte betejat në kushte që i dukeshin më të përshtatshme. Ai gërshtoi dhe përdori gjerësisht manovrën e shpejtë të forcave të veta me sulmet e befasishme mbi ushtritë armike në çdo kohë, ditën dhe natën, duke i shoqëruar këto në mënyrë të përsosur me prita e kurthe të ndryshme. Skënderbeu kishte aftësi të jashtëzakonshme ushtarake. Ai ishte në të njëjtën kohë strateg dhe ushtar, hartonte e ndryshonte në përshtatje me situatat planin e luftës, udhëhiqte ushtrinë dhe njëkohësisht luftonte edhe vetë.

të ndryshme. Skënderbeu kishte aftësi të jashtëzakonshme ushtarake. Ai ishte në të njëjtën kohë strateg dhe ushtar, hartonte e ndryshonte në përshtatje me situatat planin e luftës, udhëhiqte ushtrinë dhe njëkohësisht luftonte edhe vetë. Pjesëmarrja e gjerë e shqiptarëve në ushtrinë e Skënderbeut la gjurmët e veta në taktikën dhe armatimin e saj. Variantet taktike që përdorte Skënderbeu për të shpartalluar ushtrinë armike ishin të larmishme e mbështeteshin në bashkërendimin e mbrojtjes me sulmin, të mësymjes së ushtrisë së rregullt me goditjen e çetave, të ndeshjeve ballore me sulmet e befasishme, duke futur në përdorim si këmbësorinë ashtu edhe kalorësinë e armatosur lehtë. Në çdo luftim Skënderbeu përqijë ta parashikonte ecurinë e tij, sulmonte e hapte betejat në kushte që i dukeshin më të përshtatshme. Ai gërshtoi dhe përdori gjerësisht manovrën e shpejtë të forcave të veta me sulmet e befasishme mbi ushtritë armike në çdo kohë, ditën dhe natën, duke i shoqëruar këto në mënyrë të përsosur me prita e kurthe të ndryshme. Skënderbeu kishte aftësi të jashtëzakonshme ushtarake. Ai ishte në të njëjtën kohë strateg dhe ushtar, hartonte e ndryshonte në përshtatje me situatat planin e luftës, udhëhiqte ushtrinë dhe njëkohësisht luftonte edhe vetë.

Fitoret e arritura shqiptarët i paguan shumë shtrenjtë. Shpresat për ndihma nga jashtë pothuajse ishin prerë. Vetëm Venediku, që vazhdonte të ishte në luftë me turqit, i dha Skënderbeut

një ndihmë prej 3 mijë dukatesh dhe disa qindra ushtarë, duke nxitur që të sulmonte Elbasanin. Republika ishte mjaft e shqetësuar sepse sanxhakbeut të Elbasanit i qe ngarkuar detyra të sulmonte Durrësin e ta përfshinte në sanxhakun e vet. Duke marrë Durrësin, turqit, të cilët kishin në duart e veta edhe Vlorën, vinin në rrezik epërsinë e republikës në Adriatik. Dëbimi i turqve nga Elbasani ishte në radhë të parë në interes të vetë shqiptarëve. Skënderbeu e shikonte se me ndihmat e pakta të Venedikut nuk mund të përballohej më lufta plot sakrificë kundër osmanlinjve. Për të kërkuar burime të reja, të cilat i kishte gjetur vazhdimisht në vend, thirri në janar të vitit 1468 në Lezhë, një kuvend të krerëve shqiptarë. Në pragun e kuvendit një ushtri turke, duke ardhur nga Kosova, sulmoi Shkodrën. Skënderbeu, i cili ato ditë ndodhej i sëmurë në Lezhë, nuk mundi të merrte pjesë në luftime. Ushtria shqiptare këtë radhë luftoi pa komandantin e vet dhe korri mbi turqit një fitore tjetër. Pas pak ditësh më 17 janar 1468 i mbuluar me një lavdi të përjetshme, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, vdiq në Lezhë. Ai u varros po aty në katedralen e Shën-Kollit.

Figura e Skënderbeut ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e ushtarakëve, të burrave të shtetit e në përgjithësi të opinionit publik europian, të cilët kanë kërkuar të nxirrnin mësim nga përvoja luftarake e shqiptarëve, sidomos kur vendet e tyre luftonin kundër pushtuesve të huaj. Këtu e ka burimin ajo literaturë e shumëllojtë dhe shumëgjuhëshe, që i është kushtuar figurës së këtij Heroi, në të katër anët e botës. Kur vërshimi osman qëndronte si një shpatë mbi Europën Qendrore, kur në Gadishullin e Ballkanit shpërthyen lëvizjet për çlirimin kombëtar etj., historianët, shkrimtarët e poetët e përdornin figurën e Heroit shqiptar si flamur frymëzues për mobilizimin e popujve të tyre në luftë për liri. Dëshmi e përhershme e vlerësimit dhe e respektit të thellë që kanë popujt e tjerë për Skënderbeun, krahas botimeve të shumta për të, janë sheshet dhe rrugët e Romës, të Parisit, të Brukselit, të Gjenezës dhe të qyteteve të tjera të vendeve të ndryshme, ku janë vendosur monumente e buste të tij ose që mbajnë emrin “Gjergj Kastrioti”.

97 vite Shqipëria Republikë

Më 5 janar 1925, Qeveria e Iljaz Vrionit dha dorëheqjen dhe më 6 janar 1925, Këshilli i Naltë e dekreton Ahmet Zogun kryeministër dhe ministër të Brendshëm.

Në shtatë vitet e fundit pas Luftës së Parë Botërore ishin ndërruar 14 qeveri dhe këto më së shumti në vitet 1920-1924. Këshilli i Naltë si institucion kryesor në fatin e qeverive, nën trysinë e politikës së kohës, mernte edhe vendime që nuk shkonin në dobi të stabilitetit të vendit. Për ta zgjidhur një herë e mirë këtë ngërç, por edhe për arsye të tjera, më 21 janar 1925 Kuvendi Kushtetues shpalli "Republikën Shqiptare", ndërsa dhjetë ditë më vonë, (31 janar 1925) Ahmet Zogu u zgjodh Kryetar i Republikës, duke qenë në të njëjtën kohë edhe kreu i pushtetit ekzekutiv. Gjatë kësaj kohe Ahmet Zogu prioritet kryesor kishte rivendosjen e stabilitetit në vend, duke mundësuar nënshkrimin e marrëveshjeve të rëndësishme ekonomike, politike e ushtarake, çka forcoi ndjeshëm pozitat e Shqipërisë.

Kushtetuta e re parashikonte një republikë parlamentare, me një president të fuqishëm që shërbente si kreu i shtetit dhe i qeverisë. Ai drejtoi Shqipërinë duke përdorur katër guvernatorë ushtarakë dhe emëroi krerët e fiseve si oficerë të ushtrisë rezervë, të cilët mbaheshin në gatishmëri për të mbrojtur regjimin kundër kërcënimeve të brendshme ose të jashtme. Ai gjithashtu mbajti marrëdhënie të mira me regjimin fashist të Benito Musolinit në Itali



dhe mbështeti politikën e jashtme të Italisë.

Regjimi i Zogut thuhet se ishte përgjegjës për zhdukjen e partive opozitare dhe të lirive civile. Shtypi ishte gjithashtu i censuruar rreptësisht gjatë regjimit.

Në fillim të vitit 1925, filluan një sërë reformash të fokusuar në ekonomi, por rezultatet ishin të përziera. Disa nga reformat përfshinin organizimin e nismave private në industri, ndërtim dhe transport. Po atë vit u pre monedha e parë shqiptare, Franga e Artë Shqiptare. Kapitali i huaj u fut si pjesë e politikës zyrtare të qeverisë së Zogut I, por qëllimi i regjimit të tij ishte në fakt forcimi i pushtetit personal dhe pasurimi i mbështetësve të tij. Kapitali i huaj,

huatë dhe forma të tjera, u përdor si mjet për të siguruar të ardhura për regjimin dhe më vonë u përdor për tejkalimin e krizave ekonomike.

Rreth kësaj kohe u krijuan katërmbëdhjetë shoqëri të reja, me një kapital fillestar prej 7,6 milionë franga ari, rreth 28% më shumë se kapitali i shoqërive në periudhën 1921-1924. Në vitin 1928, numri i ndërmarrjeve arriti në 127 dhe kapitali vendas ishte gjashtë herë më i madh se në vitin 1927, ndërkohë që ekonomia filloi të stabilizohej.

Në vitin 1925 u krijua Banka Kombëtare Shqiptare dhe iu dha koncesion investitorëve italianë. Shteti shqiptar kishte 49% të aksioneve të bankës, ndërsa Italia 51%. Në këto kushte, Italia fitoi një

pozicion më të fortë në Shqipëri. Gjatë periudhës 1925-1928, qeveria shqiptare gjithashtu rriti ndjeshëm kostot e saj.

Në vitin 1925 u krijua shoqëria SVEA (Shoqëria për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë), e cila ndihmoi në lehtësimin e marrjes së një kredie për Shqipërinë me vlerë 50 milionë franga ari. Në vitin 1927, kredia vlerësohej në 65 milionë franga ari. Interesi vjetor për këtë kredi 40-vjeçare ishte 7.5%. Shumat e shlyerjes përbënin 30%-40% të të ardhurave të të gjithë vendit.

Në vitin 1925, marrëveshjet ndërmjet agjencive financiare shqiptare (si SVEA) dhe grupeve financiare italiane, financuan 96,4% të projekteve të ndërtimit të rrugëve

në Shqipëri. Këto kredi nuk ishin ekskluzivisht për nevojat urgjente ekonomike të vendit, por për të krijuar kushte për depërtimin e mëtejshëm të kapitalit të huaj në vend. Përgjegjësitë e departamenteve të qeverisë u shpërndanë për të rritur ndërtimin e rrugëve.

Në vitin 1928 çifligjet zinin një sipërfaqe prej 200.000 hektarësh (100.000 ishin çifligje private). Berati ishte qyteti me numrin më të madh të çifligjeve, me rreth 36.000.

Infrastruktura ishte e pa mirëmbajtur gjatë kësaj periudhe. Rrugët mund të transportonin vetëm automjete më të lehta, ndërsa urat e pa mirëmbajtura pengonin transportin e makinave. Transporti detar kryhej kryesisht nga kompani të huaja. Transporti ajror i postës operohej nga italianët. Tregtia ishte elementi më i madh i ekonomisë dhe gjatë kësaj kohe qarkullimi i mallrave u rrit. Lëndët e para dhe blegtoaria ishin eksportet kryesore.

Shumë kompani italiane, angleze, franceze dhe amerikane filluan të bëjnë biznes në tregun shqiptar, të cilat u ndihmuan me marrëveshje tregtare ose me investime direkte.

Pozicioni i Italisë u forcua më tej nga Traktati i Tregtisë Detare, i cili i dha shtetit statusin e "kombit më të favorizuar". Kjo legalizoi monopolin italian në tregtinë e jashtme.

Republika e Shqipërisë në historikun e saj ka pësuar ndryshime politike të cilat janë në kohezion me zhvillimet e saj në rrugëtimin e transformimit dhe zhvillimit. Faktet historike janë ato që dëshmojnë për përpjekjet e bëra nga intelektualët e këtij vendi, për të formuar një republikë me parametrat e një shteti demokratik. Dhe kjo filloi të marrë formën e saj në Shqipëri vetëm pas viteve 90'.





“Populli është i pagabueshëm”, -thoshte ai. “Unë, ti, ai tjetri edhe mund të gabojmë, kurse populli që po tregohet kaq i durueshëm për realizimin e kërkesës që Kosovës t’i njihet statusi i Republikës, pa kurrfarë dyshimi se do të dijë se deri ku shtrihen kufijtë e durimit për fitimin e statusit të Republikës”, -kishte deklaruar në njërin nga fjalimet e tij.



40 vjet nga vrasja e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës

Presidentja Osmani: Secila kohë i ka heronjtë e vet dhe secili popull u falet atyre

Secila kohë i ka heronjtë e vet dhe secili popull u falet atyre. Heronjtë janë njerëz të zakonshëm që dëshmojnë trimëri e maturi të jashtëzakonshme në periudha të rënduara, të pasigurta e kërcënuese.

Ata nuk bëjnë përlllogaritje e kalkulime por zgjedhin të luftojnë për idealet më të larta dhe mbi çdo interes personal.

Ata nuk krijohen rastësisht, ngase rruga që zgjedhin nuk është e rastësishme. Rruga e tyre ka qëllim, e qëllimi është kauza.

Të tillë ishin Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka.

Dyzetë vjet më parë, aktiviteti patriotik i tyre u ndal dhunshëm në një atentat në Untergruppenbah të Gjermanisë, por ata inspiruan shumë të tjerë pas tyre, e vazhdojnë të inspirojnë edhe sot.

Të tre heronjtë tanë u vranë nga UDB-ja e Serbisë, e kësaj iu pre rruga një uragani përbashkues, treshes e cila brengën për atdheun e mori me vete.

Sot ndihem krenare që jam para jush në këtë përvjetor kujtimi për këta heronj që idenë e lirisë dhe të shtetit e kishin projektuar qëmoti.

Sot përkulemi para tyre dhe jemi falënderues që kauza e tyre sot është realitet.

Jemi krenar për këtë brez të heronjve, kauza e të cilëve vazhdoi ndër breza dhe u kurorëzua me shtetin e pavarur, me Republikën tonë më 17 shkurt 2008.

Jusufi, Bardhoshi e Kadriu ishin kalitur me idenë e Kosovës Republikë. Prandaj, më 1981, Jusufi fliste qartë për realizimin e saj.

“Populli është i pagabueshëm”, -thoshte ai. “Unë, ti, ai tjetri edhe mund të gabojmë, kurse populli që po tregohet kaq i durueshëm për realizimin e kërkesës që Kosovës t’i njihet statusi i Republikës, pa kurrfarë dyshimi se do të dijë se deri ku shtrihen kufijtë e durimit për fitimin e statusit të Republikës”, -kishte deklaruar në njërin nga fjalimet e tij.

Jusufi, Bardhoshi e Kadriu mbesin njerëz të sakrificës, rezistencës dhe vizionit për të ardhmen e atdheut që shumë e deshën.

Duke kombinuar aktivitetin e tyre patriotik edhe me atë kulturor në rastin e Jusufit, ata u bënë referencë e kohës për angazhimin, përkushtimin dhe këmbënguljen për idenë e Kosovës shtet.



“Puna dhe vepra e tyre na e lanë lirinë e cila na duhet si buka dhe fryma e Zotit, e këtë diti ta bëjë Jusuf Gërvalla. Ata trasuan rrugën e lirisë, ndërkaq krenaria për ta e shembulli i tyre do të përcillet ndër breza”, -kishte thënë presidenti historik, Dr. Ibrahim Rugova kur eshtrat e heronjve u sollën në Kosovë.

Prandaj, Jusufi, Bardhoshi e Kadriu janë konsistentë dhe ju kanë mbijetuar shumë situatave dhe shumë zhvillimeve.

Jo rastësisht, heronjtë tanë kishin kombinuar në mënyrë perfekte aktivitetin kulturor me atë patriotik.

Si patriotë, ata e kishin të qartë se liria nuk është koncept vetëm individual, prandaj më tërë qenien e tyre u përpoqën gjatë gjithë viteve të veprimtarisë të përbashkët synimin për liri kombëtare, për të cilën nuk ka çmim, dhe për të cilën paguan me çmimin e jetës.

Në një letërkëmbim me shokët e burgut, Jusufi dëshmon se besimin në lirinë e kishin që të tre të përbrendësuar, prandaj edhe ai nuk hezitonte asnjëherë që ta shpërfaqte.

“E ardhmja është e jona. Liria po vjen...”, -thoshte ai.

Sot tekta kujtojmë Jusufin, Bardhoshin e Kadriun, kemi mundësinë të reflektojmë për rrugën e zorshme, të cilën e ka kaluar populli ynë deri në bërjen e shtetit.

Kjo rrugë ishte e mundimshme, por edhe e lavdishme. Këta njerëz janë kryengritës, heronj, por edhe frymëzues, kauza e të cilëve ishte e qartë, pra krijimi i shtetit tonë.

Fati i Jusufit, Bardhoshit e Kadriut është i bashkëdyzuar me atë të Kosovës. Ata u detyruan ta braktisin Kosovën, porse duke pasur në mendje gjithnjë vendin, të cilit i mungonte liria.

Këtë vit ne kujtojmë 40-vjetorin e vrasjes së tyre, uraganin patriotik e kulturor të të cilëve e ndërpreu atentati, duke lënë pas emra domethënës, kuptimi i të cilëve mbushet në çdo përvjetor.

Ndoshta të tre heronjtë nuk e kanë imagjinuar kurrë se do të ikin prej kësaj bote në ditën e vdekjes së heroit kombëtar Gjergj Kastriotit, i cili ishte frymëzim i pandalshëm i tyre, por

edhe i yni.

Vrasja e Jusufit, Bardhoshit e Kadriut ishte goditje e madhe për aktivitetin edhe të mërgatës sonë, e cila që prej asaj kohe nuk ka ndaluar asnjë çast që t’i shërbejë atdheut në të gjitha mënyrat e mundshme.

Jusufi, Bardhoshi e Kadriu janë dëshmi e kontributit të çmuar që ka dhënë kjo mërgatë për shtetin tonë.

Të tre heronjtë u shuan me mallin për Kosovën. Jusufi në një letër drejtuar nënës Ajshe, më 1980, citonte fjalët e saj që ua kishte thënë qysh në fëmijëri: Rruga e nderës asht ma e zorshmja, po ma e mira dhe e vetmja rrugë e vërtetë për njeriun. Kush u mundue për nder, nder ka gjetë!”

Jusufi, Bardhoshi e Kadriu ecën pikërisht në këtë rrugë, rrugën e nderës, e zorshme, por edhe e kollajshme, e kollajshme sepse ata gjithsecili i qëndruan besnik nderit.

E në letëren e tij, ai e inkurajon nënën Ajshe, që mos të dorëzohet.

“Ma në fund, thotë ai, veç tuj mos u dorëzue në këtë kohë të vështirë, ti nanë, do ta qitësh edhe hapin tand të fundit burrnor, që të

bon si të gjitha ato nana trimnesha e fisnike shqiptare, të cilat, kur e ka lypë puna e vatanit, s’e kanë kursye e s’e kanë kajtë me lot jetën e djemve të tyre dhe kanë këndue atëherë kur kanë kukatë qyqet”, -i shkruan ai nënës së tij.


E pikërisht nëna, shtëpia dhe vendlindja, janë ato të cilave u falen heronjtë, siç thuhet në vargjet e poezisë “Do të kthehem”:

Kthehu shpejt më ke pas thënë
Se bregat më kanë molisur
Të presin shokët një varr nën bli
Porositë e babit tënd
Kaluan pranvera e vjeshta o nanë
Që kur ti e ndjell veç një kthim
Nëse vetë nuk do të mundem
Do i them birit tim

Në vendlindje le të shtrojë çdo gëzim
Ne sot e përjetë do ta nderojmë
kujtimin për të, për Bardhoshin e Kadri Zekën, sepse ata e meritojnë, sepse shteti ynë e mbanë vulën e tyre.

Njerëzit si ta njëherë hyjnë në histori në mënyrë meritore dhe mbeten përjetësisht aty! Qoftë i përjetshëm kujtimi për Jusuf e Bardhosh Gërvallën dhe Kadri Zekën!





“Një nga prioritetet më të rëndësishme gjatë mandatit tim do të jetë ruajtja e qëndrueshme e financimit të Mbrojtjes dhe arritja e 2% të PBV-së për buxhetin e Mbrojtjes deri në vitin 2024. Projektet për pajisjen dhe modernizimin e Armatës do të vazhdojnë të realizohen, do të vazhdoj të kujdesem për përmirësimin e kushteve të punës dhe standardit jetësor të personelit ushtarak dhe civil në Armatë”.



Slavjanka Petrovska merr postin e ministres së Mbrojtjes nga Radmilla Shekerinska

Me një ceremoni në Ministrinë e Mbrojtjes, Slavjanka Petrovska e mori postin e ministres së Mbrojtjes nga ministrja aktuale Radmilla Shekerinska.

Në fjalën e saj të parë si ministre e Mbrojtjes, Petrovska tha se e merr këtë post në rrethana shumë të ndryshme socio-politike nga ato që ishin në vitin 2017 dhe se sot vendi ynë është anëtar i NATO-s, që kërkon shumë punë, përkushtim dhe sakrificë politike që e gjithë kjo të bëhet realitet. Ministrja falënderoi ministren aktuale Shekerinska për investimin dhe kontributin e saj në përbushjen e këtij zotimi strategjik.

“Anëtarësimi në NATO nuk është vetëm një njohje e proceseve politike që kanë ndodhur, por edhe e gatishmërisë së Armatës sonë për të pranuar standardet e NATO-s dhe parimet e veprimit të Aleancës. Gjeneral Gjurchinovski, Ju përgëzoj ju dhe pjesëtarët e Armatës për angazhimin e deritanishëm në këtë proces jashtëzakonisht të rëndësishëm, pjesë e rëndësishme e së cilës padyshim jeni. Së bashku do të vazhdojmë në atë rrugë”, -tha ministrja.

Petrovska tha se do të jetë një shtytës i fuqishëm i zhvillimit në Mbrojtje dhe proceseve që tashmë kanë filluar, të cilat do të realizohen me dinamikë edhe më intensive.

“Një nga prioritetet më të rëndësishme gjatë mandatit tim do të jetë ruajtja e qëndrueshme e financimit të Mbrojtjes dhe arritja e 2% të PBV-së për buxhetin e Mbrojtjes deri në vitin 2024. Projektet për pajisjen dhe modernizimin e Armatës do të vazhdojnë të realizohen, do të vazhdoj të kujdesem për përmirësimin e kushteve të punës dhe standardit jetësor të personelit ushtarak dhe civil në Armatë. “Do të vazhdojë përmirësimi dhe rinovimi i infrastrukturës së objekteve ushtarake, si dhe rinovimi i objekteve me implementimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe sigurisht do të vazhdojë investimi në zhvillimin e poligonit ushtarak “Krivollak”, i cili është një resurs i vlefshëm vendor dhe i NATO-s”, -tha Petrovska.

Znj. Petrovska tha se do të ruhet niveli i lartë i transparencës dhe integritetit në punë, do të merret parasysh përfaqësimi i drejtë dhe zbatimi i politikave korrekte gjinore në Mbrojtje dhe Armatë.

Lidhur me bashkëpunimin me aleatët, me të cilët ndajmë vlera të njëjta, ministrja Petrovska tha se do të zhvillojmë ndërveprueshmërinë dhe do të vazhdojmë të marrim pjesë në operationet dhe misionet ndërkombëtare paqeruajtëse.

Ministrja aktuale e Mbrojtjes Shekerinska theksoi se mbrojtja në 4 vite e gjysmë ishte pjesë e diçkaje më të madhe se ne dhe se është shkruar një histori që ia vlen të kujtohet. “Më kujtohet 4 vite e gjysmë më parë kur thashë se do të ndryshonim “status quo”-në në Mbrojtje. Sot Mbrojtja nuk njih “status quo”. Sot nuk ka asnjë problem që është i pazgjydhshëm. Sot sistemi funksionon. Arritëm ta kthejmë



Republikën e Maqedonisë së Veriut në procesin e integrimit në NATO-s, jemi anëtare e NATO-s, të njëjtë dhe të barabartë me të tjerët, të integruar ushtarakisht në një kohë rekord në historinë shtatë dekadëshe të Aleancës.

Në vitin 2017 thashë se pjesëtarët e Armatës që ruajnë këtë vend do të marrin dinjitetin dhe respektin që u takon me një standard më të lartë dhe kushte më të mira pune, me kujdes të treguar qartë nga shteti. Sot ky është një realitet. Jam

angazhuar për një rritje të vazhdueshme të buxhetit të Mbrojtjes, por edhe për transparencë maksimale para publikut, i cili duhet të ketë një pasqyrë se si dhe ku shpenzohen paratë. Ne i kemi ofruar të dyja me sukses 100%. Ne kemi treguar se kemi kapacitet për të thyer barrierat dhe për të arritur gjëra të mëdha. “Sot, gjithçka që dukej e pamundur katër vite e gjysmë më parë është bërë ngadalë realitet,” -tha Shekerinska.

Ministrja aktuale falënderoi stafin e Mbrojtjes dhe pjesëtarët e Armatës, sepse siç tha ajo, sinqeriteti, ndershmëria dhe profesionalizmi i tyre kanë qenë frymëzim dhe motiv për punë edhe më intensive.

“Leadershipi për mua nuk ka qenë asnjëherë një funksion i privilegjit të statusit apo pozicionit, por vetëm i veprimit, vendimmarrjes, marrjes së përgjegjësisë dhe shembullit personal. Faleminderit që më mbështetët në këtë. Unë shoh tek ju shumë profesionistë të vërtetë që janë të denjë për kushte edhe më të mira pune. Ne e kemi bërë institucionin tonë të parin në shumë gjëra, së pari në

transparencë, në krye të Europës për sa i përket integritetit në funksionim. Dhe kjo është gjëja më e rëndësishme, të punohet me integritet, me një motiv të fortë dhe pa kufizime”, -tha ajo.

“Nuk ia dolëm me pritshmëritë, por i rritëm dhe më pas së bashku i tejkaluam. Jam e bindur se do të vazhdoni në këtë. Jam e bindur se rezultatet do të vazhdojnë të vijnë dhe do të jetë kënaqësia ime personale që sistemi që kemi ngritur ka vazhduar të rritet. E kam ditur gjithmonë se liria që kemi luftuar për të së bashku në disa raste është shumë e rëndësishme për ne. Ajo që kam mësuar në vitet e fundit është se liria shkon vetëm së bashku, ajo jeton, mbron dhe zhvillohet së bashku me përgjegjësinë. Liria vërtetë kërkon përgjegjësi, përgjegjësi për të bërë një ndryshim, për të kontribuar, për të përmirësuar dhe për të arritur më shumë. Vazhdoni të mbronni atdheun dhe lirinë, me punë të përkushtuar dhe rezultate të dukshme”, -përfundoi Shekerinska në fjalimin e fundit si ministre e Mbrojtjes.

Shekerinska, ministrja e parë e Mbrojtjes që nderohet me flamurin amerikan

“Mirënjohje për bashkëpunimin e shkëlqyer dhe aleancën e fortë mes Maqedonisë së Veriut dhe SHBA-së”

Jam e nderuar, e kënaqur, është kompliment dhe privilegj i madh sot të jem ministrja e parë maqedonase që merr flamurin e SHBA-së si simbol dhe mirënjohje për bashkëpunimin e shkëlqyer dhe forcimin e partneritetit dhe aleancës”, -tha ministrja Radmilla Shekerinska, sot në ceremoninë për nder të saj ku nga ambasadorja amerikane Kejt Meri Bërns iu dorëzua flamuri amerikan.

Ky akt, i njohur në diplomacinë amerikane si shprehja më e lartë e respektit për punën e politikanëve nga vendet e huaja, që manifestohet, ndër të tjera, edhe me përzgjedhjen e një flamuri të ngritur në një nga institucionet zyrtare të qeverisë amerikane, shënon vitin më të suksesshëm në këto 28 vite bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes mes Maqedonisë së Veriut dhe Shteteve të Bashkuara.

“Nuk ka shpërblim më të madh për një ministër mbrojtjeje sesa puna dhe pjesëmarrja në dy rezultatet historike të dy viteve të fundit pandemike, anëtarësimi në NATO në 2020 dhe integrimi i plotë ushtarak me Aleancën në 2021. Këto suksese janë krenaria jonë kombëtare, por ato kanë një “Një vullë nga aleati ynë dhe mbështetja dhe ndihma e fortë

amerikane qëndron pas tyre,” -tha Shekerinska.

Pas këtij akti, shtoi ministrja, qëndrojnë takimet dhe bisedat që pata fatin dhe nderin të bëj me të gjithë sekretarët e deritanishëm të Mbrojtjes të SHBA-së në 4 vitet e fundit, kolegët e mi Matis, Shenenehen, Esper dhe Ostin, bisedimet me gjeneralin Tod Walters, admiralin Bërk, gjeneralët Kavoli, Hokanson, Najt, asistentët e Mbrojtjes Kuper dhe Nal – të gjithë kontribuan që mozaiku i bashkëpunimit tonë të jetë i pasur dhe të ketë rezultat të dukshëm historik.

“Në të njëjtën kohë, pas kësaj miqësie dhe aleance qëndrojnë misionet dhe operationet e përbashkëta që kanë kontribuar që Maqedonia e Veriut të shfaqet në skenën ndërkombëtare dhe të bëhet nga një importues, një eksportues i vërtetë dhe i besueshëm i stabilitetit dhe sigurisë. Jam e sigurt se flamuri që mora sot, si dhe flamuri maqedonas që mora një vit më parë nga kolegët tanë të NATO-s, do të dëshmojë për tundimet që kaluam, por do të dëshmojë edhe për rezultatit e përbashkët historik që arritëm dhe jam e sigurt se miqësia dhe bashkëpunimi i dy vendeve që besojnë në vlerat e njëjta do të vazhdojë të zhvillohet edhe më tutje”, -tha ministrja Shekerinska.

Ambasadorja amerikane, Kejt Meri Bërns, theksoi se falë vizionit dhe ndikimit të ministres Shekerinska, Armata e Maqedonisë së Veriut po përparon me shpejtësi me modernizimin, integrimin në NATO dhe zhvillimin e vazhdueshëm të forcave të armatosura sipas standardeve të NATO-s.

“Gjatë udhëheqjes suaj, Shtetet e Bashkuara dhe Maqedonia e Veriut kanë thelluar dhe intensifikuar marrëdhëniet e tyre dypalëshe të mbrojtjes më shpejt se kurrë në historinë tonë 28-vjeçare të bashkëpunimit të mbrojtjes. Vitin e kaluar ne nënshkuam një memorandum të bashkëpunimit të mbrojtjes, zbuluam flamurin e Maqedonisë së Veriut në korridorët e Pentagonit dhe përfunduam disa marrëveshje për modernizimin e pajisjeve,” -tha ambasadorja Bërns në ceremoni.

Në ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës Vasko Gjurchinovski, si dhe përfaqësues të tjerë të Armatës dhe Ministrisë, si dhe mysafirë të lartë nga ambasada amerikane, ndërsa në pjesën zyrtare përveç Gardës së Armatës, morën pjesë edhe marinsat amerikanë.

Shqipëria, muze i gjallë i së kaluarës

Një ndër elementet që mban të lidhur zinxhirin e prejardhjes kombëtare janë edhe kultet tradicionale shqiptare, ishte albanologu i shquar Robert Elsie, ai që na solli rezultatet e kërkimit të tij, në fusha të tilla si antropologjia dhe etnografia, të cilat dëshmojnë se Shqipëria është e pasur me shumë figura kultesh, e ndaj e ka quajtur “një muze i gjallë i së kaluarës”. Sipas Elsie, para-ilirët dhe ilirët konsiderohen si popuj të natyrës dhe format e para të perëndive i gjetën të gatshme në natyrë.

Ata mahnitëshin nga dukuritë e natyrës dhe veçoritë e objekteve të ndryshme, si: drurët, kafshët, shpendët, zvarranikët etj., të cilët i hyjnizuan dhe ky veprim hyjnizues shërbeu, si totemi a si kult për fiset ilire në lashtësi.

Të tilla kulte janë: kulti i Diellit, i Tokës, i zjarrit, i kalit, i kaut, i ujkut, i gjarprit, i dhisë, i gurit, i shqiponjës etj. Në këtë shkrim, Elsie parafrazon edhe studiuesin e njohur arbëresh të Zarës së Kroacisë Aleksandër Stipčević, kur bën përshkrimin e kultit të figurës së çapit.

KULTI I TOKËS

Kulti bazë i ilirëve ishte ai i tokës. Ky kult lidhej me pjellorinë e përvitshme të saj, çka i bënte banorët ta konsideronin atë mëmë të të gjithë kulteve. Ky kult vihet re edhe sot në sentencat popullore, si: “për këtë tokë”, “më zëntë sytë buka e kësaj toke”, “mos më trettë toka”, “pasha tokën e pasha qiellin”, etj.

KULTI I ZJARRIT DHE I DIELLIT

Tashmë edhe Prometeu e ka kryer “dënimin”, që mori prej Zeusit, për shkak se, ua dha njerëzve sekretin e zjarrit dhe kjo “ngjarje” është e fiksuar, jo më vetëm si legjendë, por edhe në shkrimet e autorëve të antikitetit, p.sh. nga Eskili të “Prometeu i lidhur”. Zjarri është konsideruar i shenjtë për vlerat e tij dhe për ndryshimet, që solli në botën njerëzore, gjatë hapave të para të saj.

Në gojëdhënat popullore flitet për vatrën, për zjarrin, madje, edhe kur duan të mallkojnë, njerëzit shprehin: “T’u shoftë zjarri!”, “T’u shoftë vatra!”, “Për këtë zjarr!”, “Për këtë zjarr e mu shoftë vatra!”, “T’u shoftë kandili!”, “T’u shoftë drita!” etj., Autorët e lashtësisë njoftojnë se, për të ruajtur zjarrin në çdo shtëpi, lihej një njeri.

Shumë sinjifikativ është fakti se gjatë pushtimit osman, midis taksave të shumta kishte edhe një taksë për tymin, apo për oxhakun. Nga ky fakt mbeti e dhe shprehja, “shtëpi oxhaku”, e cila do të thoshte “derë e lartë”. “Zjarri shikohet edhe si personifikim i familjes...”, konkludon studiuesi R. Memushaj në monografinë “Historia e Kurveleshit”. Sentencat, “Iu shua kandili!”, “Iu shua zjarri!”, “Zjarr i shuar”, “Vatër zjarri (e ngrohtë, mikpritëse)”, “E shoi atë zjarr lumëmadhi” etj. e konfirmojnë këtë ide.

Kulti i zjarrit është i lidhur me kultin e Diellit, i cili mendohet edhe si burim i jetës, i të mirave materiale etj. Elementet e natyrës kanë qenë një burim adhurimi, por mbi të gjithë: dielli, toka dhe hëna kanë qenë adhuruar si hyjni në gjithë hapësirën pellazgjike dhe ilire (ilire, epirotase dhe dardane).

Populli ruan në kujtesën e tij disa shprehje, të cilat i përdor si urim, mallkim, betim etj., siç janë: “Për këtë dhe!” “Për këtë qiell”, “Për këtë Diell”, “Për atë Diell”, “Për këtë Hënë”, “Për këtë vatër”, “Për këtë zjarr”, “Të thertë rrezja e Diellit”, “Për atë Diell, që vete lodhur e këputur” “Për atë symadh, që i sheh të gjitha”. “Qofsh i bardhë, si rrezja e Diellit” etj.

Këto sentenca e kanë origjinin përtej kufirit të besimit monoteist, në kohët e be-



simit pagan dhe janë dëshmi e autoktonisë së elementit bartës, pra të vazhdimësisë iliro-shqiptare.

Një tregues specifik i kësaj vazhdimësie është edhe riti i varrimit, i cili që nga lashtësia pellazgjike është i pandryshueshëm. Vendosija e kufomës me fytyrë nga dielli dhe me kokë nga Perëndimi, si edhe krijimi i një rrethi, që simbolizon Diellin në varrezat tumulare, janë një tjetër dëshmi e vazhdimësisë dhe tregues i kultit të Diellit. “Sipas besimit pagan, -konfirmon baroni F. Nopça, shqiptarët nderonin Diellin, duke iu falur majave të malit”.

Edhe sot, në majën e Tomorrit, shpellën e Sari Salltikut në Krujë, kurorën e malit në Gribë, Selgijka në Malin e Gjerë mbi Lazarat, në Gjakovë e gjetkë respektohen, si vende pelegrinazhi, majat e maleve. Kulti i diellit, sipas autorëve antikë: Herodotit, Strabonit, Ciceronit dhe Plutarkut, por edhe Durham, Nopça, Stipčević, Sbashlaqiq, Shuteriqi, Shkupi e Tirta, dëshmojnë se Dielli ka qenë objekt i tatuazheve ndër iliro-shqiptarët.

Në historinë romake, vihet re qëndrimi i perandorit me origjinë ilire, Kostandinin të Madh, i cili i urdhëronte ushtarët e tij të recitonin të diellin, “ditën e dritës dhe të Diellit”, një lutje Diellit, që do t’u sillte fitoren”. Ky kult pagan ka ekzistuar edhe në shekullin V-të të e. s. Këtë e mësojmë nga vizita e papës Leo i Madh (440-461) në trojet ilire. Kur papa vizitoi Kostandinopojën, në hyrje të kishës së Shën Pjetrit, ai vuri re disa njerëz që predikonin kultin e Diellit. Papa, me këtë rast, ua bëri një kritikë të ashpër këtyre predikuesve.

KULTI I HËNËS

Krahas kultit të solarit (Diellit) ka ekzistuar edhe kulti i Hënës. Shpesh të njerëzit e moshuar dëgjohej betimi: “Për këtë Diell dhe për këtë Hënë”. Kulti i saj e ka burimin në lashtësi. Ky

kult ka pasur një përhapje të gjerë në popullin tonë. Kulti vihet re në kultin e pjellorisë. Kulti i Diellit është i lidhur me kultin e tokës. Dielli dhe toka përfytyroheshin si një kult çift, ose si nënë dhe babë edhe në popujt e tjerë. Egjiptianët e mendonin tokën si një burrë të stërmadh të shtrirë me kurriz.

Me kultin e Diellit është simbolizuar edhe Krishti. Në monedhën e Vetransios (350), simboli i Krishtit shprehet “Sol Invictus”; gjithashtu Shën Pjetri në një mozaik paraqitet si një Koçi, duke u ngjitur drejt Diellit. Kulti i Diellit dhe i Hënës gjenden edhe në toponimet tona. Kështu në rrethin e Tepelenës burimet ujore cilësohen, si: “Kroi i Diellit”, “Kroi i Hënës”. Tregojnë mbi një njeri, duke ecur rrugës ndeshi në një çetë hajdutësh.

Pasi e grabitën, njëri prej hajdutëve, i cili u njoh nga i grabituri, e vrau me thikë kalimtarin. Kur po jepte shpirt, burri tha: “Ti, moj Hënë e plotë, më marrësh hakën dhe qofsh dëshmitare”. Pas disa kohësh, hajduti me një shok shkoi ta vidhte një varr. Pasi gërmuan varrin dhe nxorën çfarë dëshën, hajduti nguli thikën në tokë për të pasur duar të lira. Provoi të ngrihej, por s’mundi? Pa hënë, ajo ishte e plotë. Atëherë mendoi se Hëna po merrte hak. I vdekuri, me duar të padukshme e kishte kapur hajdutin. I traumatizuar vdiq, ndërsa shoku që besoi se hëna, si dëshmitare e ngjarjes, po merrte hak, u largua me shpejtësi. Të nesërmen, kur njerëzit shkuan në varreza, panë se thika kishte shpuar fustanellën dhe kishte penguar hajdutin të ngrihej.

KULTI I SHQIPONJËS

Shqiponja është një shpend me veti për t’u admiruar. Popujt e lashtësisë i evidentuan cilësitë e shqiponjës dhe u bënë adhurues të saj. Shqiptarët e konsiderojnë veten se janë bijë të

shqiponjës, ose që banojnë në vendin e saj. Studiuesi Aleks Buda konfirmon: “Shqiponja në flamurin tonë ka kuptimin e një simboli etnik e një totemi, d.m.th., të një kafshe të shenjtë, që konsiderohet si i pari i fisit.”

Shqiponja dhe simboli saj e kanë burimin te shqiponja zeusiane. Madje, edhe vetë Zeusi i Dodonës konsiderohej një shqiponjë. Pirro i Epirit u thirr prej ushtarëve të tij shqiponjë. Ai iu përgjigj ushtarëve: “Është merita juaj që unë jam shqiponjë dhe si të mos jem, kur ju me armët tuaja më keni ngritur lart, si me krahë të shpejtë. Nga ky dialog studiuesit shohin edhe burimin e emrit Shqipëri = Shqiponjë.

Gjatë mesjetës, shqiponja është e pranishme në heraldikat e familjeve të mëdha feudale, si te Kastriotët, Muzaqajt dhe Dukagjinët. Simboli i unitetit tonë kombëtar gjeti një pasqyrim më të madh në epokën e Rilindjes Kombëtare. Shqiponja gjendet e gdhendur në: porta, dyer, oxhaqe, taverne, varreza, mburoja, tatuazhe, djepa, furka, kuti duhani, orendi shtëpiake etj., të cilat janë dëshmi e përhapjes së kultit të këtij shpendi madhështor në Shqipëri.

KULTI I KALIT

Kulti i kalit për shumë studiues ka një bazë të gjerë shtrirjeje në popujt dhe vende të ndryshme, por Fetusi, në shekullin e II para e. s., shkruante se perëndia e Neptunit më parë ndër fiset ilire quhej hippius, që do të thotë “me kalërue, me hip”. Ka të dhëna se, edhe mbreti i detit ndër ilirët quhej hyji i detit dhe në paraqitjen e tij grafike është dhënë në formën e kalit, për nder të të cilit për çdo nëntë vjet ilirët i flijonin detit katër kuaj. Në lashtësinë dhe në antikitet, ilirët përmenden si një popull që flijojnë kalin, si gjënë më të shtrenjtë, për t’i nderuar Zotat.

Anijet e famshme ilire, të cilat u bënë shqetësuese edhe për Senatin

Romak, kishin të gdhendura në bashet e tyre kokat e kuajve. Prania e figurës së kalit konsiderohej fatsjellëse, sepse kali ishte kthyer në një kult për fiset ilire. Studiues të ndryshëm e konsiderojnë vendimtar depërtimin e kalorësve nomadë të stepave veriore (nga fundi i epokës së bronzit në epokën e hekurit) në përhapjen e kultit të kalit. Gjuhëtarët kanë shprehur mendimin se, fjala “kalë” e ka origjinën nga gjuha shqipe. Kështu studiuesi austriak, Karl Traimer, shprehet: “Vetë emri hipus, që quhet kali, lidhet me foljen “hip”, d.m.th. të kalërosh.”

KULTI I KAUT

Zbulimet arkeologjike, shënimet e autorëve të antikitetit dhe gojëdhënat rreshtojnë në listën e kulteve për ilirët edhe kultin e kaut. Koha e kultit të tij lidhet me adhurimin e gjedhëve në përgjithësi dhe me shpikjen e parmendës e të qerreve, të cilat tërhiqeshin nga qetë. Studiuesit janë të mendimit se ky kult daton që në epokën e patriarkatit.

Arkeologët e gjetën kafkën e kaut në qendër të një tume në Pazhok të Elbasanit dhe legjendat na thonë: “Kadmi dhe e shoqja, Harmonia, e përshkruan rrugën, për në Iliri, të hipur në një çift qesh (gjedhësh). Stefan Bizanti njofton se, për nder të qeve të Kadmit, në veri të Ilirisë, një qytet kishte emrin Buthoe. Sikurse dihet, tashmë është e studiuar mirë origjina e emrit të Butrintit, Buthrot = vend i rritjes së demave.

Në jetën e përditshme gjejmë njësi frazeologjike, të cilat lidhen me kultin e kaut si: “Të dihej e mira e kaut se thernin bota”, nisur nga fakti se kau punon tokën. Shpesh dëgjohej njerëz të moshuar: “Kau ka uratë”, “Mishi i tij nuk duhet të hahet”. Madje, për të mos e lodhur, mërztur dhe për ta vlerësuar kaun bujqit, që lërojnë tokën, duke ngarë qetë dhe duke ecur me parmendë në dorë, u thonë qeve: “Ho, vëlla, ho, avash, vëlla, avash, hë, të keqen hë!” etj.,

KULTI I UJKUT

Shpesh në rrjedhat e historisë së popujve, përveç kafshëve shtëpiake, në lashtësi janë adhuruar edhe grabitqarët, duke u shërbyer fiseve të ndryshme si kulte, apo si toteme. Një nga këto kulte është edhe adhurimi i ujkut për ilirët, të cilët na e kanë përcjellë këtë emër edhe si toponim në emrin e qytetit të Ulqinit, për të cilin studiuesit mendojnë se lidhet drejtpërdrejt me emrin e ujkut.

Figura e ujkut gjendet edhe te perandori i Ulqinit, në shekullin XIV. Adhurimi i grabitqarëve lidhet me veçoritë fizike të tyre dhe me faktorët psikologjikë, si besimin, se po të merrte në të mirë uju, nuk do të ishte dëmprurës etj. Prezenca e ujkut si totem evidentohet, jo vetëm si toponim, por edhe si heraldik, ndër familjet feudale shqiptare të mesjetës. Këtë e konfirmon heraldika e Balshajve.

Studiuesi Kristo Frashëri, në vëlimin e tretë të studimeve për epokën e Skënderbeut, thekson: “Balshajt kishin në emblemën e tyre ujkun, me të cilin është lidhur legjenda e themelimit të qytetit të Ulqinit”. Kulti i ujkut, ashtu si shumë hyjni, i kapërcen kufijtë e mijëvjeçarëve. Ai vjen që nga koha e hyjit Apollon, i cili ishte i lidhur me totemin, me ujkun.

Është kjo arsyeja pse studiuesi Muzafër Xhaxhiu thekson në shkrimin e tij “Rruga për tek pellazgët”: “Ky Hy, quhej Apollon Lyken, nga fjala shqipe ulk me metatezë”.

KULTI I DHISË

Kulti i dhisë e ka zanafillën në legjendën për Zeusin, i cili u fsheh nga e ëma, Rea, në mal dhe atje u

ushqye me qumështin e një dhie. Gjatë rrjedhës së historisë, dhia ilire ishte me famë, jo vetëm për qumështin, por edhe për faktin se, ajo pillete dy herë në vit dhe bënte nga dy dhe tre keca.

Pirro i Epirit dhe Skënderbeu i mbanin brirët e dhive në përkrenaret e tyre. Prezenca në përkrenaren e Pirros dhe atë të Skënderbeut simbolizonte fat dhe orën e mirë që sillte dhia për mbretin, mbretëritë dhe ushtritë e tyre. Në legjendën e Mujit dhe Halilit, tri dhitë briarta janë mbrojtëse të tyre.

Shpesh çjapi është përdorur edhe si kurban. Studiuesit konfirmojnë se çjapi dhe dhia janë përdorur si simbole të flijimit për perënditë në lashtësi. Folklori shqiptar është një tjetër dëshmi e kultit të dhisë. Si argument ilustrues po sjellim simbolizimin: "Tri dhitë e shenja të zanave", të Çabejt. Përveç kultit të dhisë, Herodoti shkruan se, në luginën e Vjosës ka qenë i pranishëm edhe kulti i deles. "Në luginën e Vjosës, thotë ai, mbaheshin në shpellë një tufë dhensh të shenja kushtuar Diellit".

KULTI I LISIT

Autorët antikë na tregojnë se në lashtësi fiset ilire (ilirët, epirotët dhe dardanët), krahas kulteve të tjera si ata të kaut, gjarprit, kalit, gurit etj., kishin edhe kultin e lisit (dushkut), kult, i cili u trashëguar tek ata nga pellazgët.

Roberto d'Angeli në librin "Enigma", thekson: "Kulti i druizmit është një një lidhëse ndërmjet fesë pellazge dhe bektashizmit. Ky kult, argumenton ai, duke filluar prej Dodone u përhap edhe në Perëndim me disa sekte". Jacues është i mendimit se, fjala "dru" vjen nga keltishtja dhe ka kuptimin "lis" dhe "i urtë".

Duke iu referuar Dilerikut dhe Plinit mësojmë se qyteti i Drinopojës quhej Drys dhe themeluesja e këtij qyteti ishte Dropeja, e cila ishte e bija e mbretit Eukalis. Sipas legjendës: Dropenë e rrëmbeu Apolloni dhe e shndërroi në lis. Numizmologët, në një monedhë antike, kanë zbuluar Zeusin e Dodonës që mban në kokë një kurorë prej lisi, ndryshe nga figura ku Zeusi paraqitet me rrufe e shtizë.

Kurora me lis është fatsjellëse... edhe për ushtarët e Pirros. Kurse në anën tjetër të medaljes gjendej një gjarpër dhe një lis, të cilat ishin kulte të kohës pellazgo-ilire. Nga lisi i shenjtë i Dodonës mollosiane, tradita homerike na thotë se, ndërtuesit e anijes "Argo", morën një copë dhe ndërtuan bashin e anijes.

Eskili, përveç përshkrimit të rrugës, që të çon në Dodonë, na bën të ditur ekzistencën e lisave të shenjtë. "Lisat që flasin, thotë ai, janë një mrekulli që imagjinata s'mund ta rrokë". Autorë të tjerë të antikitetit theksojnë se, nëpërmjet shushurimës së gjetheve të lisit, Zeusi shprehte vullnetin e tij.

Në Iliri, sikurse bëjnë të ditur autorët e antikitetit, siç e përmendëm edhe më lart, gjendeshin pyje lisi të shenjtë, në të cilët rriteshin gjarpërinjtë, të cilët, gjithashtu, konsideroheshin si kult dhe ushqeheshin çdo vit prej tri femrave të virgjëra, që shkonin në pyll lakuriq. Një pyll i tillë ka ekzistuar në zonën e Lunxhërisë, vend i cili edhe sot nga banorët vendas quhet serpënt = gjarpër nga latinishtja.

Emrat e vendeve dhe lisat shekulorë në qendër të fshatrave të Shqipërisë së Jugut, janë sot një dëshmi e ekzistencës së kultit të lisit. Në fshatin Miricë të Tepelenës, deri në vitet shtatëdhjetë të shekullit XX, gjendej pylli i shenjtë i lisit, për të cilin populli betohej: "Ja Lisat e Mericës", "Për të dymbëdhjetët mekamët e Miricës".

Po kështu janë edhe "Lisat e Kadhe" në Kurvelesh, lisi i Shtëpëzës, lisat e Pilurit pranë kishës, kisha e Lirishtes mbi kalanë antike të Leklit, lisat e Hyse dhe lisi i Age në Kalivaç, lisi i Levanit dhe lisat e Rabijes në rrethin e Tepelenës, lisi i Gjerbësit në

Mallakastër etj. Studiuesi M. Tirta, në shkrimin e tij "Mite e besime në bregdetin e sipërm të Himarës", thekson: "Lisi ishte (në Himarë, shënim i SH. H.) dru i adhuruar dhe me cilësi shenjtërie". Kjo vihet re në arkivolin e të vdekurit të cilin e bënin gjithmonë me dru lisit.

KULTI I GJARPRIT

Gjarpri, ky zvarranik me aftësi të çuditshme, ka luajtur një rol të rëndësishëm në religjionin dhe mitologjinë ilire. Kulti i gjarprit, është evident edhe te shumë popuj të botës që nga Azia Lindore e deri në Amerikë. Shumë e njohur dhe e famshme është legjenda e Gjarprit Hitit, emri i të cilit ishte Illurjanka, që për disa autorë shërben si burim nga rrjedh edhe emri ilir. Autorë të këtij mendimi janë: gjermani O. Gruppe dhe filologu sloven K. Oshtiri.

Në aspektin kohor, simbolika e gjarprit në trevën shqiptare gjendet përtej kufirit të formimit të etnosit ilir. Ky kult është prezent edhe sot në përralla, legjenda e tregime të ndryshme, brenda gjithë hapësirës etnike shqiptare. Kulti i gjarprit, në rrafshin botëror, daton prej kufirit paleolitik dhe vjen deri në ditët tona, ndërsa në trevat ilire ai evidentohet qysh nga koha e neolitit.

Megjithatë, nga epoka e neolitit e deri në epokën e hekurit, arkeologët ende nuk kanë zbuluar një simbolik të qartë të këtij kulti. Ky fakt arkeologjik i ka shtyrë studiuesit albanologë të mendojnë se fizionomia e plotë e këtij kulti i takon periudhës së hekurit, shek. VI-V para e. s. Rrua

e kulteve, për të cilët ata ishin bartës të tyre.

Shumë sinjifikative është legjenda, të cilën na e ka përshkruar Apolodori. Sipas tij: "Kadmi, pasi kërkoi dhe nuk e gjeti të motrën Evropën, që e kishte rrëmbyer Zeusi, u vendos në Tebë dhe u martua me Harmonin, e cila ishte e bija e perëndisë së luftës, Aresit, dhe e perëndeshës Afërdita. Me urdhër të perëndive Kadmi shkoi në mbretërinë e Enkelejeve dhe u bë mbret i tyre.

Në mbretërinë Enkeleuse ata lindën një djalë, i cili në momentin e lindjes u mbështoll nga gjarpri mistik. Djalit ia vunë emrin "Ilir" nga rrjedh edhe emri i Ilirisë. Në kohën e pleqërisë Kadmi dhe Harmonia u shndërruan në gjarpërinjtë të shenjtë.

Kulti i gjarprit respektohej edhe prej familjeve mbretërore. Kështu Olimpia, bashkëshortja e Filipit dhe nëna e Aleksandrit të Madh të Maqedonisë, e cila ishte e bija e mbretit të Epirit, disa herë ishte parë të mbështillte rreth trupit gjarpërinj të gjallë.

Autorët antikë dhe kujtesa popullore na ofrojnë edhe legjenda të tjera për gjarprin, prej të cilave po veçoj legjendën e gjarprit të Bisticës. Në zonën e Delvinës në lashtësi ishte një gjarpër i madh (Kuçedra), i cili ishte bërë tmerri i zonës, sepse, jo vetëm kishte zënë burimet, por edhe hante çdo gjë, madje edhe njerëzit. Tentativat për ta vrarë gjarprin kishin dështuar, por funksionoi plani i një plaku.

Plaku ngarkoi një gomar me eshkë dhe qymyr. Kur përbindëshi ishte në gjumë, plaku e shpuri gomarin në vendin ku flinte dhe ndezi një eshkë. Gjarpri, pasi e hetoi gomarin e hën-

shuante. Që të shpëtonte nga dhimbjet gjarpri lëvizte me shpejtësi në shpatin e malit mbi Delvinë.

Nga lëvizja u formua një vijë e drejtë, ku nuk mbin bari. Këtë vijë vendosit e quajnë: "rruga e gjarprit", atje, ku sot, gjendet një dukuri komplekse natyrore me origjinë gjeologjike, në të dyja anët e së cilës ka mbirë valanidh. Me kokat e gjarprit, u ngrit, thotë legjenda, manastiri i Mesopotamit. Në muret e poshtme të manastirit të Mesopotamit, gjendet një gur i madh në faqe të së cilit, është gdhendur një gjarpër, i cili është ndoshta dragoi shqiptar.

Albanologu Robert Elsie, në veprën "Leksiku i kulturës popullore shqiptare, besime, mitologji, fe, doke, rite, festa dhe veçori kulturore", thekson: "Gjarpri ka qenë simbol i fuqishëm i ilirëve të lashtë, sidomos i atyre të Ballkanit jugor. Në periudhën romake, në Dardani, kishte altar kushtuar gjarpërinjve Drakon dhe Drakaena".

Forma e gjarprit gjendet në shumë figura, skulptura, objekte zbulurimi e stoli të ndryshme, varëse në përmendoret e periudhës romake etj. Në pjesën e poshtme të murit të manastirit të Mesopotamit, në Delvinë, gjendet një gjarpër i gdhendur në gur, me krahë dhe me bisht të përdredhur, i cili mendohet e motivohet edhe si dragoi shqiptar.

Në luginën e Vjosës, gjarpri është prezent në skulpturën e një femre, e cila është gjendur në fshatin Qesarat të rrethit të Tepelenës. Skulptura është prej guri gëlqeror dhe ka një lartësi 0.98 m. Në të paraqitet një femër me një shportë të mbushur me fruta në

si dhe për lindjen e gruas," shton ai.

Gjarpri ishte një figurë, i cili adhuronte shumë në gjithë luginën e poshtme të Vjosës gjatë antikitetit. Ai është prezent edhe në monedhat e Bylisit, Amanties dhe Apolonisë. Aleksandër Stipçeviq jep këtë shpjegim për figurën e çjapit, që është në luftë me gjarprin, skenë, e cila gjenden në monedhat e kolonisë greke të Farit: "Çjapi simbolizon kolonët dhe gjarpri ilirët".

Kulti i gjarprit mund të evidentohet edhe sot, ndërsa të gjitha krahinat. Mendohet se çdo shtëpi ka gjarprin e saj, që konsiderohet mbrojtësi i shtëpisë dhe njihet me emra të ndryshëm: "Vitorja e shtëpisë", "Roja e shtëpisë", "Boa", "Uratë e shtëpisë", "Zot i truallit të shtëpisë", "Tokësi" "Gjarpri i shtëpisë" etj. Ky gjarpër nuk vritet, por edhe nuk është i dëmshëm për të zotët e shtëpisë, të cilët nuk tremben prej tij. Në zonën e Tepelenës besohet se kur dikush vret një gjarpër, "I zoti i jetës" thotë: "Vrau miza një Ezhderha".

Një element tjetër, i cili dëshmon për kultin e gjarprit në trojet shqiptare, është njoftimi i autorëve të antikitetit se në Iliri kishte pyje të posaçme, ku rriteshin gjarpërinjtë, të cilët ushqeheshin një herë në vit prej tri femrave, që shkonin atje të zhveshura. Nëse pranohej ose jo ushqimi, priftërinjtë bënin parashikimin e ecures së motit, prodhimit, mënyrës së qeverisjes, mundësisë së zhvillimit të luftërave etj.

Kulti i gjarprit te pellazgët dhe te ilirët (ilirët, epirotët dhe dardanët shënim i SH. H.), ishte një totem, ndërsa te shqiptarët konsiderohet edhe sot si mbrojtës prej fatkeqësive. Gjarpri i shtëpisë ose Vitorja ka qenë e shenjtë. Ajo ishte mbrojtësjja e familjes, e njerëzve, sillte mbarësi në njerëz, në prodhime, në bujqësi, blegtori e në pemëtari.

Figura e gjarprit gjendet e skalitur edhe në portat e shtëpive, zbulurimet e ndryshme me gdhendje druri, si në: tavane, musëndra, dyer, furka tjerreje, culla dyjare, çifteli, kërraba, në përmendoret e varreve etj., duke përfshirë një areal të gjerë në zona të ndryshme të vendit si në: Përmet, Labëri, Çamëri, Malësi e Madhe, Dukagjin, Kosovë, Malësi e Tiranës etj. Mark Tirta, gjatë studimit të dokeve dhe zakoneve të Malësisë së Tiranës, konfirmon se koka dhe lëkura e gjarprit përdorehin në këtë trevë si hajmali për fëmijët, për t'u mbrojtur nga syri i keq dhe sëmundjet e ndryshme. Prania e kultit të gjarprit edhe në ditët tona, me një shtrirje në të gjitha trevat shqiptare, dëshmon për një kult të përbashkët shqiptar, i cili u ka rezistuar dogmave të besimeve monoteiste.

KULTI I GURIT

Me kultin e gurit lidhen një sërë ritesh popullore siç janë: betë, faljet në vendet e shenja; gjithashtu ruhet edhe besimi për gurin e pragut të derës etj. Beja mbi gur është shprehur edhe në kanunin e Lek Dukagjinit. Në shumë raste njerëzit betohen: "Për atë gur", "Për gurin e pragut", "Mos e kapërceftsh gurin e pragut" etj. Kulti i gurit haset edhe në formën e besimit. Kështu, besohet në Labëri, në Gostivar, Tetovë, Kosovë etj.

Guri është përdorur gjerësisht edhe në folklorin shqiptar në gjithë hapësirën etnike. Në vargjet e këngëve popullore dëgjojmë shpesh: "Kam themelin tek ky gur/besa jam shqiptare e se ul flamur".

Kultet e lartpërmendura mund t'i përmbledhim në një përkufizim, i cili përgjithësisht gjendet në shumë fjalorë të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të huaja. Kult fetar konsiderohet një shërbesë fetare për nder të një hyji, për të cilin zhvillohen ceremoni mistike.

Shyqri Hysi –
"Gjurmime albanologjike
Folklor dhe etnologji"



mitologjike e kultit të gjarprit fillon në Mesopotami, përcillet në Azinë e Vogël dhe këtej në botën mesdhetare, nga ku egjeanët dhe fenikasit tregtarë e përcollën në Perëndim.

Por, sipas analitikës sonë, edhe një rrugë tjetër duhet të jetë ndjekur. Bëhet fjalë për popujt kurganë, të cilët iu drejtuan Ballkanit, në vitet 2700-2500 p.e.s. Studiuesit janë të mendimit se lëvizja e popullit pellazgjik bëri të mundur edhe përhapjen

gri, por eshka vazhdonte të digjej nga frymëmarrja e gjarprit dhe bashkë me të edhe gjarpri. Meqenëse nuk i duronte dot dhimbjet i kërkoi ndihmë perëndisë së detit dhe Bisticës.

"Ku je, o nëna ime Bisticë dhe ti motra det? ". Bistrice nxori 18 burimet e Syrit të Kaltër, por kjo nuk i mjaftonte gjarprit, i cili e kuptoi gabimin dhe thirri: "Ku je, nëna ime det dhe ti motra Bisticë?". Deti erdhi deri në Finiq, por nuk arriti ta

dorën e majtë, rreth së cilës është mbështjellë një gjarpër, koka e të cilit drejtohet për nga frutat në shportë.

Arkeologët shqiptarë, H. Ceka dhe S. Anamali, janë të mendimit se këtu gjarpri simbolizon bollëkun e prodhimit. Të njëjtin mendim e shpreh edhe M. Xhaxhiu, kur thekson: "Një rëndësi të veçantë ka pasur te ne roli i gjarprit në çështjen e pjellorisë së tokës, si forcë vepruese për mbarësi dhe bollëk të prodhimeve bujqësore,

TË RINJTË I PËRGJIGJEN FUSHATËS SË REKRUTIMEVE PËR USHTARË/DETARË



Qindra të rinj e të reja në të gjithë vendin i janë përgjigjur njoftimit për fushatën e rekrutimit për ushtarë-detarë në Forcat e Armatosura të Shqipërisë. Këtë të enjte, ekipi i përfaqësuesve të FA-së ishte në qytetin e Durrësit, ku nën moton “Ti ke forcën që nderon kombin!”, vijoi informimin e të rinjve dhe të rejave duke i ftuar ata të zhvillojnë karrierën brenda FA-së.

Fushata u ndoq edhe nga zëvendësministrja e Mbrojtjes, Dallëndyshe Bici, e cila tha se: “Angazhimi si pjesë e FA-së të jep nder e krenari. Jemi shumë të kënaqur me regjistrimet në qytetin e Durrësit”.

Fushata e rekrutimeve përveç qendrave të rekrutimit në çdo qark, deri më tani ka shkuar në disa qytete si Elbasan, Korçë, Lushnje, Shkodër, Vlorë, etj. Janë rreth 400 vende të lira aktualisht pranë FA-së për ushtarë dhe detarë aktivë për të gjithë të rinjtë apo të rejtat nga 18 deri në 27 vjeç me arsim 9-vjeçar, të mesëm apo të lartë. Të gjithë kandidatët fitues do të përfitojnë një pagë mujore dinjitoze si asnjëherë më parë, përgatitje fizike dhe profesionale të vazhdueshme brenda dhe jashtë vendit sipas standardeve të NATO-s dhe një karrierë të sigurt.

Ti ke forcën që nderon kombin!

Zëvendësministrja e Mbrojtjes Bici: Angazhimi si pjesë e FA-së të jep nder e krenari. Jemi shumë të kënaqur me regjistrimet në qytetin e Durrësit

